

# RAPORTI PARAPRAK VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.

HIDROCENTRALI “KIRI 1”, KOMUNA POSTRIBE, QARKU SHKODËR.



**Pergatitur nga :**

“TAULANT”sh.p.k.

QKL, LN-7574-03-2014

Eksperte mjedisi:

Ditika Qatipi

Erjona Qatipi

**Bashkepunim me, “EBS” sh.p.k.**


Ing.hidroteknik Fahri MAHO.

Ing. hidroteknik Julian ÇELA.



**Investitor**

“ACCESS ENERGY ALBANIA”sh.p.k



Tiranë, 2014.



## PARATHENIE

Hartimi i vlerësimit paraprak te VNM- së, është kryer në bazë të ligjit: **10440 datë 07.07.2011** Për vleresimin e ndikimit në mjedis), **neni 8, Shtojca II** (Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis), **pika 3** (industria e energjisë), **germa (ë)** (instalime për prodhimin e ënergjisë hidroelektrike).



## **Permbajtja**

### **Hyrje**

#### **1) Informacion per qellimin e VNM dhe metodika e zbatuar.**

- a) *Pershkrimi i qellimit dhe objektivat e VNM*
- b) *Pershkrimi i permbledhur i kuadrit ligjore mjedisor edhe instutucional qe lidhen me projektin*
- c) *Pershkrim te metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM –se*
  - *Autoret e hartimit te raportit te thelluar te VNM-se*
  - *Metodika e zbatuar dhe menyra e sigurimit te informacionit per hartimin e raportit te VNM-se.*
  - *Konsultimet e realizuara gjate hartimit te raportit te thelluar te VNM-se*
  - *Nje pershkrim te veshtirsive qe zhvilluesi ka hasur gjate hartimit te informacionit te kerkuar.*

#### **2) Pershkrimi i projektit.**

- a) *Pershkrimi i qellimit te projektit*
- b) *Planimetria e vendosjes se projektit , ku pasqyrohet:*
  - *Siperfaqja e zones se kerkuar*
  - *Kufijte e siperfaqes se kerkuar.*
  - *Te dhena mbi siperfaqen e tokes qe do te perdoret nga projekti ne ndertim dhe funksjonimi i tij.*
- c) *Skicat dhe planimetrite e objekteve te projektit dhe strukturavete projektit*
- d) *Peshkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike*
  - *Kapacitetet prodhuse /perpunuese*
  - *Sasite e lendeve te para*
  - *Produktet perfundimtare te projektit qe do te zhvillohet.*
- e) *Infrastruktura e nevojshme per zbatimin e projektit*
  - *Lidhja me rrjetin elektrik*
  - *Furnizimi me uje*
  - *Shkarkimin e ujrave te ndotur*
  - *Shkarkimi i mbetjeve*
  - *Informacion per rruget egzistuese dhe nevojen e hapjes se rrugeve te reja*



- f) Programi per ndertimin
  - Kohezgjatja e ndertimit
  - Kohezgjatja e planifikuar per funksjonimin e projektit
  - Faza e planifikuara per rehabilitimin e siperfaqes pas mbarimit te projektit
- g) Menytrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit
- h) Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materjale ndertimi, uji dhe energji)
- i) Informacion per lidhjet e mundeshme te projektit me projektet e tjera prane projektit tone.
- j) Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret.
- k) Perdorimi i lendeve te para gjate funksjonimit si: Sasia e ujet te nevojshem , energjine, lenda djegese dhe menyren e sigurimit te tyre.
- l) Aktivitete te tjera qe mund ti nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertimi i kampeve dhe rezidencave.
- m) Informacionper lejat dhe licensat e nevojshme per projektin e kerkuar, nga ligjislacionit ne fuqi si dhe institucionet ne fuqi si dhe instutucionet kompetente perlejimin , licensimin e projektit.

**3) Nje pershkrim i analizes te zbatimit te projektit dhe elementeve te vecante te tij , si dhe arsye per alternative e zgjedhur duke marre parasysh ndikimet ne mjedis te seciles alternative.**

**4) Nje pershkrim i gjendjes dhe i vlerave egzistuese te mjedisit qe mund te ndikohen nga zbatimi i projektit te propozuar.**

#### **4.1 Pershkrimi i karakteristikave fizike te zones se projektit.**

- Pershkrimi i faktoreve klimaterik
- Pershkrimi gjeomorfologjik dhe i sizmicitetit i zones
- Pershkrimi gjeologjik dhe tokes ne vndin e zbatimit te projektit
- Pershkrimi i ujrave siperfaqesore dhe nentokesore te zones

#### **4.2 Pershkrimi i biodiversitetit ne zonen ku zbatohet projekti.**

- Pershkrimi i habitateve kryesore ne zonen e projektit dhe harta ilustruese
- Pershkrimi i vegjitacionit ne secilin habitat dhe statusi i ruajtjes kombetare dhe nderkomtar i tyre



- *Pershkrimi i zones se mbrojtur prane vendit ku propozohet projekti*

#### **4.3 Pershkrimi i cilesise se mjedisit dhe ndikimet egzistuese.**

- *Cilesia e ujrave ne zonen e studiuar.*
- *Cilesia e ajrit ne zonen e studiuar*
- *Niveli i zhurmave ne zonen e studiuar*
- *Administrimi i mbetjeve*
- *Problemet e tjera : si erozjoni i tokes ,zjarret,etj.*
- *Presjonet kryesore te mjedisit ne zonen e projektit , si ndotje te mjedisit, prerje pyjesh etj.*

#### **4.4 Pershkrimi i karakteristikave sociale te zones ku do te zhvillohet projekt.**

- *Njesia e qeverisjes vendore qe administron zonen ku zhvillohet aktiviteti*
- *Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike te zones*
- *Perdorimi i tokes ne zonen e projektit*
- *Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike ne afersi te zones se projektit*
- *Administrimi i mbetjeve dhe ujrave te ndotur urbane*

### **5) Pershkrimi i ndikimeve negative te rendesishme te projektit te projektuar mbi mjedisin**

#### **a) Ndikimet negative ne mjedis.**

- *Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit*
- *Ndikimet negative ne habitate dhe biodiversitet te zones se projektit*
- *Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi I mbetjeve*
- *Ndikimet negative shtese (kumulative) ne cilesine e mjedisit ne zonen e projektit dhe burimet natyrore si mineralet,pyjet,burimet ujore.*
- *Ndryshimet sociale te projektit , si ndryshimi I perdorimit te tokes dhe shqetesimet qe mund te lindin nga ndikimet ne mjedis te projektit si zhurma,pluhri,perdorimi i burimeve natyrore etj.*
- *Pershkrimi i pasojave te aksidenteve te mundeshem me pasoja ne mjedis .*



**b) Karakteristikat e ndikimeve negative ne mjedis.**

- Metodat e zbatuara per parashikimin e ndikimeve ne mjedis
- Shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te indentifikuara (Shkalla)
- Lloji i ndikimeve te indentifikuara (direkte dhe jo indirekte)
- Mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe argumentimet perkatese nese per ndikime te caktuara nuk mund te merren masa zbutese.
- Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve te projektit si: zona te mbrojtura, habitate, qendra te banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj.

**6) Ndikimet ne mjedisin nderkufitare te projektit.**

**7) Ndikimet positive ne mjedisin e zones se projektit.**

**8) Masat e propozuara per tu mbrojtur nga cdo ndikim negative ne zbatimin e projektit.**

**9) Programi i monitorimit te ndikimeve ne mjedis gjate zbatimit te projektit.**

**10) Plani i manaxhimit dhe monitorimit te mjedisit.**

- Rolet dhe pergjegjsit per zbatimin e seciles mase te propozuar per mbrojtjen e mjedisit ne secilen faze te projektit.
- Kostoja perkatesete zbatimit te masave te propozuara per mbrojtjen e mjedisit
- Plani i komunikimit dhe informimit te publikut per ndikimet ne mjedis , masat e marra per mbrojtjen e mjedisit dhe monitorimin e ndikimeve ne mjedis gjate zbatimit te projektit.

**1) Informacion per qellimin e VNM dhe metodika e zbatuar.**

**a) Pershkrimi i qellimit dhe objektivat e VNM.**

Objektivat e VNM-se konsistojne ne analizimin e faktoreve lokale e negative mjedisore, ne dhenien e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative, si dhe tenton ne permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit gjate ndertimit dhe shfrytezimit te hidrocentraleve.

Qellimi i VNM eshte, qe nepermjet vleresimit cilesor e sasior paraprak te parametrave hidrologjike te treguesve gjeologo-inxhinjerike, parametrave sizmo-tektonike, morfologjike e gjeomorfologjike te bazuara ne kritere e standarte shkencore nderkombetare, tipizohen dhe te perzgjidhen nje sere parametrash dhe vecorish te sistemeve te



siperpermendur natyrore, ne sherbim te infrastruktures mjedisore, te infrastruktures urbane si dhe ndertimit dhe shfrytezimit te HEC etj.

Ky raport ka per qellim te sherbeje:

- Si instrument per mbrotjen e mjedisit;
- Ne fuqizimin e komunitetit per veprime ne mbrojtje te mjedisit;
- Ne kontrollin e perdorimit te qendrueshem te burimeve natyrore;
- Ne rritjen e mireqenies nga menaxhimi afatgjate i burimeve ujore;
- Ne mbrotje te pasojave financiare dhe social-ekonomike;
- Ne rritje te interesimit per bashkepunim dhe ne gjetjen e zgjidhjeve te reja, etj.

***b) Pershkrimi i permbledhur i kuadrit ligjore mjedisor edhe instutucional qe lidhen me projektin.***

Qeveria Shqiptare ne Qershor te 2003 aprovoi Strategjine Kombetare te Energjise, si nje dokument baze te zhvillimit te te gjitha sektoreve energjttike deri ne vitin 2015. Strategjia analizon tre ceshtje:

- 1) Situaten e furnizimit dhe kerkeses se energjise deri ne vitin 2015.
- 2) Strukturen institucionale te sektorit te energjise.
- 3) Pergatitjen e paketes financiare dhe te afateve kohore per implementimin e seciles mase, ne baze te rekomandimeve te rezultuara nga Strategjia Kombetare e Energjise.

Objektivi Primar i Strategjise Kombetare te Energjise eshte:

‘Rikonstruimi i sektorit energjitik bazuar ne parimet e ekonomise se tregut si dhe ne zhvillimin e nje poiltike bashkekohore energjitike’

Strategjia Kombetare e Energjise parashton kerkesat e domosdoshme per te plotesuar detyrimet e vendit tone perkundrejt Tregut Rajonal te Energjise Elektrike ne vendet e Europes Jug-Lindore. Per kete vendi yne duhet te plotesoje te gjitha obligimet nderkombetare qe kane te bejne me mbrojtjen e mjedisit dhe te harmonizojte zhvillimin e sektorit energjitik ne perputhje me Direktivat e Bashkepunimit European, per te bere te mundur asocimin e Shqiperise ne Europen e Bashkuar.

Ojate dhjetevjecarit te fundit Qeveria ka filluar zhvillimin e nje kuadri ligjor per te ndryshuar degradimin mjedisor, i cili ka ardhur si rezultat i industrializimeve te





meparshme, dhe ka anashkaluar mbrojtjen e mjedisit pothuajse plotesisht. Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit jane pjese e Legjislacionit, i cili kerkon "te mirembaje nje mjedis te pershtatshem, te shendetshem dhe ekologjik per brezat e sotem dhe te ardhshem".

Legjislacioni kerkon gjithashtu qe treguesit urban duhet te shfrytezohen racionalisht ne perputhje me principe te bazuara.

### Masterplani i Gjenerimit te Energjise Elektrike

Per periudhen afatshkurter (deri ne vitin 2009), dhe duke pasur parasysh edhe kohen e ndertimit te centraleve te reja, nevojat shtese gjeneruese te Shqiperise do te plotesohen vetem duke rritur importin (i cili do te perdoret si ngarkese baze) (deri ne 2.5-3 TWh/vit). Per pasoje, eshte e rekomandueshme te mbahet ne planifikim niveli i importit te vitit 2001 (1.7 TWh/vit) dhe te punohet per instalimin e TEC-it CCGT (135 MW), i cili te arrije te vihet ne pune ne vitin 2009 (fig).




Figura.: Masterplani i Zhvillimit te Gjenerimit te Energjise Elektrike

Gjithashtu mbeshtetur ne Strategjine Kombetare te Energjise llogaritet qe te instalohen rreth 160 MW, HEC-e te vegjel me nje prodhim mesatar rreth 780 GWh/vit. Per te perballuar nevojat shtese elektro energjetike dhe per te reduktuar nivelin shume te larte te importit, ne skenarin aktiv te Strategjise Kombetare te Energjise jane konsideruar per tu identifikuar si TEC-e ashtu edhe HEC-e, ato kandidatet, te cilet do te mbeshtesin mbulimin e nevojave te reja shtese. Perfitimi me i madh nga shfrytezimi i energjise ujore realizohet neper ndertimit te hidrocentraleve te medhenj, por interes paraqet edhe shfrytezimi i energjise ujore neper hidrocentraleve te vegjel. Keto hidrocentrale jane kryesisht te tipit me derivacion dhe shfrytezojne burimet dhe rrjedhjet ujore prane ketyre zonave dhe mesatare e ketyre hidrocentraleve eshte 25 vjecare.



**c) Pershkrim te metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM  
-se**

- *Autoret e hartimit te raportit te thelluar te VNM-se.*

**REFERUAR:**

LITERATURA:	AUTORI	VITI BOT.
1) Klasifikimi i tokave te Shqiperise	K.Cara; F.Gjoka	2003
2) Hartografimi gjeologo-ambiental	J. Hoxha	2000
3) Buletini mjedisor	A.K.M	1999, 2000
4) Harta e klasifikimit te tokave te Shqipërisë	Grup autorësh	2003
5) Hidrologjia e Shqipërisë	HMI	1984
6) Raport mbi gjendjen e mjedisit ne Shqipëri Plani Kombëtar i Veprimit ne Mjedisit	Grup autorësh	2004
7) Gjeografia fizike e Shqipërisë (Vëll 1 & 2)	F. Krutaj	1991
8) Hidrogjeologjia	Xh. Xhemalaj	1997
9) Ekologjia	N. Peja;	1999
10) Ekologjia dhe ekosistemet e saj	V.Peculi; A.Kopali	2006
11) Web site te ndryshme.		

- *Metodika e zbatuar dhe menyra e sigurimit te informacionit per hartimin e raportit te VNM-se.*

Studimi vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua

- nga rendesia e ndertimit dhe shfrytezimit te Hec KIRI 1 me standartet bashkekohore,
- nga permbushja e kerkesave vendase dhe te huaja,
- nga vendi ku ai ndodhet, pasurite natyrore e humane te zones si dhe vlerave te vecanta te tyre,
- ne idenifikimin e ndikimeve negative dhe lokale,
- ne marrjen e masave zbutese, duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike te investimit,
- ne masat orientuese per nje zhvillim te qendrueshem etj.

Ne kete raport identifikohen ndikimet lokale e negative ne mjediset humane, si dhe eshte mare parasysh vleresimi i rrezikut.



Reduktimi i ndikimeve negative, eshte nderthurur edhe me ndikime te rendesishme lokale dhe strukturore ne keto faza kyesore:

- Hartimi i objektivave orientuese te Raportit te VNM-se;
- Mbledhja e materialit baze eksistues dhe plotesimi i formularit perkates per kete raport (relacioni teknik, studimi gjeologo-inxhinierik, hidrologjik, etj), si dhe seleksionimit te tyre per perdorim.

Verifikimi ne terren i te dhenave ekzstuese dhe mbledhja e te dhenave te mundeshme biofizike dhe humane;

- Hartimi i VNM-se dhe dorezimi tek porositesi, si dhe ne subjektet vendimarese dhe kontrolluese te aspekteve mjedisore ne nivel lokal dhe qendror.

- *Konsultimet e realizuara gjate hartimit te raportit te thelluar te VNM-se*
- *Nje pershkrim te veshtirësive qe zhvilluesi ka hasur gjate hartimit te informacionit te kerkuar.*

## 2) Pershkrimi i projektit.

"Ndërtim-Operim-Transferim te Hidrocentralit KIRI 1 ne rrjedhjen e Lumit te Kirit"

Vendodhja: Qarku Shkoder.

**Karakteristikat teknike te Hidrocentralit KIRI 1 qe do te ndertohet ne rrjedhjen e Lumit te Kirit, operoj dhe transferoj ne kete zone te rrethit te Shkodres-Qarku Shkoder:**

Karakteristikat	Te dhenat
Kuota e vepres se marrjes Nr.1 Niv.Normal (m)	308.50
Kuota e vepres se marrjes Nr.2 Niv.Normal (m)	307.16
Kuota e vepres se marrjes Nr.3 Niv.Normal (m)	304.00
Kuota e vepres se marrjes Nr.4 Niv.Normal (m)	310.30
Kuota e Biefit te Siperem (Basen Presioni) (m)	295.75
Kuota e Biefit te Poshtem (Kuota e shkarkimit) (m)	133.00
Kuota e Godines se Centralit (m)	133.00
Renia Bruto (m)	162.75
Renia Neto (m)	161.82
Prurja Llogaritese Qll Nr.1 (m <sup>3</sup> /sek)	9.63



Prurja Llogaritese Qll Nr.2 (m <sup>3</sup> /sek)	1.35
Prurja Llogaritese Qll Nr.3 (m <sup>3</sup> /sek)	2.56
Prurja Llogaritese Qll Nr.4 (m <sup>3</sup> /sek)	0.91
Gjatesia Kanali V.M. Nr.1 - Hyrje Tuneli (m)	308.00
Gjatesia Hyrje Tuneli - V.M. Nr.2 (m)	2465.00
Gjatesia Tuneli V.M.Nr.2 - V.M. Nr.3 (m)	2064.00
Gjatesia Tuneli V.M.Nr.3 - Dekantues (m)	3317.00
Gjatesia e tunelit me presion (m)	1000.00
Tipi I turbines (cope 2 )	Francis
Fuqia e Instaluar (kw)	19187.00
Prodhimi vjetor I Energjise (Kwh/vit)	77428463.00

Ne kuder te zhvillimit te politikave afatgjate per rritjen e kapaciteteve te shfrytezimit te burimeve te rinovueshme te energjisë. Ne nje prizem me te gjere ky projekt ne menyre indirekte do te ndikoj ne plotesimin deri diku te nevojave energjetike per energji elektrike pra duke përdorur energji të ripërtëritshme qe vleresohet sot si "energji e paster". Projekti ne menyre indirekte gjithashtu ka për qëllim zvogëlimin e emetimeve të gazit me efekt sere (CO2) duke shmangur pengesat për zhvillimin e energjisë së përtëritshme.

Duke synuar zhvillimin strategjik e ketyre rezervave ujore per prodhim te energjisë së përtëritshme (kryesisht SHPP) Projekti do ta rrisë pjesën e burimeve të ripërtëritshme në strukturën e prodhimit të energjisë elektrike ne rang rajonal per Republikën e Shqiperise. Zhvillimi i projekteve per prodhimin e energjisë së rinovueshme është i vlefshëm që nga:

- (I) kostot e prodhimit në përgjithësi janë konkurruese me forma të tjera të prodhimit të energjisë elektrike,
- (II) se do të rrisë diversifikimin e furnizimit me energji elektrike dhe sigurinë e energjisë,
- (III) se do të kontribuojë në reduktimin e emisionet dhe ndotja.

Shoqeria **"ACCESS ENERGY ALBANIA"** Shpk, do të ushtroj veprimtarine e saj te shfrytezimit te rezervave ujore per prodhim te energjise elektrike gjatë gjithë periudhës së marrjes me koncesion per rreth 35 vjet. Buxheti i propozuar i projektit është rreth 1246348886 lek

Leke pa tvsh, nga të cilat 2.000.000 Leke qe do te investohen per rehabilitim te mjejdisit te cilet do te sigurohen si grante psh. koncesionet kane te drejt te disponojne, te kryejne transaksione me pale te trete dhe te shese pjese te energjise elektrike te prodhuar nga ky hidrocentral duke perfshire edhe transaksionet qe ka te beje me prodhimin e energjise se rinovueshme dhe vecanerisht në lidhje me Mekanizmat e Zhvillimit te Pastertise (Clean Development Mechanism) ne kuadrin e Protokollit te Kyoto-s. Pjesa tjetër do të

kontribuohet nga burimet financiare te vete shoqerise investitore, perfitim ky i mundesuar nga prodhimi dhe shitja e energjise elektrike ndaj konsumatorit lokal.

a) *Pershkrimi i qellimit te projektit*

**VENDODHJA & VLERËSIMI I RAJONIT NË KUSHTET FILLESTARE**

Lumi I Kirit ndodhet ne krahinen malore qendrore, Kiri është një fshat në komunën Pult në rrethin e Shkodrës të Shqipërisë. Fshati është i vendosur në hyrje të Pultit, duke ndjekur në të kundërt rrjedhën e lumit me të njëjtin emër. Në lashtësi ka pasur një kala që sot ka vetëm disa rrënoja dhe asgjë më tepër, por edhe sot ky vend emërtohet "Qyteza e Kirit" ose "Kalaja e Kaurrit". Popullsia është e përbërë nga di sa degëzime.

Emrin e këtij fshati e mban edhe lumi i cili buron nga shpatet e Bigës, Ndërkjores e Qafës së Bëshkasit dhe derdhet në Drin, pranë Kalasë së Shkodrës. Me sa duket lumi ka marrë emrin e fshatit dhe jo fshati emrin e lumit, sepse në kohët e hershme ky lumë kishte emrin Clusala. Rrjedha e lumit nuk është e qëndrueshme sepse varet nga reshjet edhe pse furnizohet nga përronj nga Alpet Shqiptare. Është i pasur me trofta. Mbi këtë lum qëndron Ura e Mesit i ndërtuar gjatë sundimit osman që i ngjan kurrizit të një mushke, harku i së cilës kujton atë të Urës të Mostarit, në Bosnje.

Skema e Hec Kiri 1 per projekt zbatim shtrihet ne nje distane prej 9.5 km. Eshte i perbere nga 4 vepra marrje me prurje llogaritese ne total 14.45m<sup>3</sup>/sek .

Hydrocentrali Kiri 1 do te jete i perbere nga 4 vepra marrje te cilat kane siperfaqe te pellgut ujembledhes perkatesisht VM. Kiri 1= 19.76 Km<sup>2</sup> , VM. Kiri 2 = 10.46Km<sup>2</sup>. VM. Kiri 3 = 7.03 Km<sup>2</sup>, VM. Kiri 4 =74.38 Km<sup>2</sup>.

Vepra e pare ndodhet afersisht 1000 m poshte pikes se bashkimit te lumit te Kirit me perroin Gallës. Vepra e marrjes Nr.2 ndodhet nr degezimin e perroit te Terfilles me lumin Kir. Vepra e Marrjes nr.3 ndodhet ne afersi te fshatit Brucaj (Likaj) dhe mbledh ujerat e perroit te Cudit , perroit Bregu I Flaket dhe ato te lumit Kir. Vepra e marrjes nr.4 ndodhet ne afersi te fshatit Kir (Mark Nonaj) dhe mbledh ujerat e perroit Telash.

Pjesa më e madhe e pellgut ujembledhes eshte ne zone malore dhe me pjerrësi te medha gjatësore te lumit dhe tërthore te afluenteve qe drenojne ne këtë lum.



Pak a shume forma masive malore e ketij pellgu eshte e rrumbullakosur por vihen re edhe thepiset e shpateve ku relievi i tij ngrihet shume shpejt sidomos ne pjesen e mesme dhe te siperme te ketij pellgu. Siperfaqja e ketij pellgu eshte 134.13 km<sup>2</sup>.

Qellimi i tij eshte te prodhoje dhe te furnizoje me energji elektrike zonen lokale dhe rajonale si dhe "Rritja e prodhimit te energjise elektrike ne Shqiperi".

Ai do te perbehet nga 2 agregate me turbine tip Francis dhe me kapacitet fuqi te instaluar

**F= 19 187 Kw** dhe do te prodhoje nje energji **E=77 428 463 kwh/vite**

b) *Planimetria e vendosjes se projektit , ku pasqyrohet:*

- *Siperfaqja e zones se kerkuar. Siperfaqja e ndertimit te kerkuar eshte 96228m<sup>2</sup>.*

### Prurjet ekologjike.

Per HEC "KIRI 1" eshte perpiluar tabela e llogaritjes se prujes ekologjike per 4-akset e veprave e marrjes per HEC "KIRI 1", gjithashtu kemi permendur dhe ligjin 111/2012 dt.15.12.2012 ku shprehet: "Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355)".

**Tab.1. permbledhese e prurjeve karakteristike ne akset e shfrytezimit te HEC-eve Kiri 1**

Nr	1	2	3
EMERTIMI	Prurja mes. vjetore (m3/sek)	Prurja llog. (m3/sek)	Prurja ekologjike (m3/sek)
V. M. NR. 1	7.586	9.63	0.758
V. M. NR. 2	1.066	1.35	0.1066
V. M. NR. 3	2.01	2.56	0.201
V. M. NR. 4	0.717	0.91	0.0717

Me poshte po japim vlerat e kurbes se qendueshmerise se prurjeve ditore per vitin mesatar ne akset e veprave te marrjes te HEC "Kiri 1" per te nxjerre Q(355).



**Tab.3 Vlerat e kurbes se qendueshmerise se prurjeve ditore per vitin mesatar ne akset e veprave te marrjes te HEC Kiri 1**

Ditet	Ditet mbetese	Q=50%(VM 1)	Q=50%(VM 2)	Q=50%(VM 3)	Q=50%(VM 4)
3.65	3.65	50.824	7.147	13.502	4.804
18.27	14.62	28.972	4.074	7.697	2.738
36.54	18.27	20.133	2.831	5.349	1.903
73.08	36.54	15.967	2.245	4.242	1.509
100.12	27.04	10.394	1.462	2.761	0.982
146.16	46.04	7.579	1.066	2.013	0.716
182.70	36.54	6.056	0.852	1.609	0.572
219.24	36.54	3.454	0.486	0.918	0.326
255.78	36.54	1.956	0.275	0.520	0.185
292.32	36.54	0.843	0.119	0.224	0.080
328.86	36.54	0.638	0.090	0.170	0.060
347.13	18.27	0.426	0.060	0.113	0.040
365.40	18.27	0.205	0.029	0.054	0.019

Nga tabela me sipër shohim që për katër akset e veprave

**Tab.5 Prurjet Q355 për katër akset e veprave të marrjeve HEC “KIRI 1”**

EMERTIMI AKSIT	Prurja Q355 (m3/sek)
V. M. NR. 1	0.37
V. M. NR. 2	0.05
V. M. NR. 3	0.11
V. M. NR. 4	0.035

Shenim: Prurjet Q(355) për secilin aks të veprave të marrjeve të HEC “KIRI 1” janë nxjerre me anë të interpolimit ndërmjet rreshtit të parafundit dhe të fundit të tabelave “Vlerat e kurbes së qëndrueshmërisë së prurjeve ditore për vitin mesatar në akset e veprave të marrjes”.



Po te bejme krahasimet ndermjet prurjve te  $10\% \cdot Q_{mes}$  me ato te  $Q(355)$  rezulton se  $10\% \cdot Q_{mes}$  eshte me e madhe se  $Q(355)$  per secilin aks, keshtu qe referuar **ligjit 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore"**, si prurje ekologjike do te pranohen ato te pershkruara me siper ne tabelen, por ne raportin e VNM,  $Q(ek) = 10\% \cdot Q_{mes}$ .

*11) Kufijte e siperfaqes se kerkuar.*

Pra siç shihet, objekti qe ne po studiojme ndodhet ne krahinën malore veriore, sipas ndarjes gjeografike te vendit tone nga Qendra e Studimeve Gjeografike.

Pellgu ujembledhes i Lumit te Kirit pjesa ku do te zbatohet Hec Kiri 1 nga veriu kufizohet me malin e Mgulles, nga qafa e Stenes dhe nga qafa e malit te Shoshit. Nga lindja kufizohet me malin e Biges, malin e Sukes. Nga perendimi kufizohet me malin e Bishkazit, malin e Molles etj. Ndersa ne jug pelgu ujembledhes Lumit te Kirit per pjesen tone te projektit kufizohet me malin e Kashtyllit, malin e Sollomonit malin e Sules dhe malin e Cekes.

*12) Te dhena mbi siperfaqen e tokes qe do te perdoret nga projekti ne ndertim dhe funksjonimi i tij.*

Terreni eshte i mbuluar kryesisht nga brezi me bime shtat shkurter dhe nga ai i dushqeve shtat larte.

Truallin mbi te cilen do te vendosen nenobjektet e Hec – it eshte ne pronesi te banoreve vendas dhe shtetit. Per procedurat e shpronесimit do ndiqen te gjitha hapat ligjore midis paleve.

Terreni ku do te kalojne nenobjektet e Hec – it KIRI 1 ben pjese ne terren paramalor dhe jo shume te shfrytezueshem per nevoja bujqesore perjashto ekonomite familjare, por vetem per ato kullosore.

Ne pjesen e mesme te vepres karakterizohet nga nje terren qe vjen gjithnje ne ngritje ne menyre te dukshme.

Ndersa ne pjesen e siperme te vepres karakterizohet nga nje terren i thyer gjithnje ne ngritje por ne menyre me te ashper qe e rrit pjerresine e shpateve.





c) Skicat dhe planimetrite e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit.

- Vepra e marrjes nr.1.




Figura: Paraqitja Skematike e Vepres se Marrjes.



- Dekantuesi dhe Baseni i Presionit.




Figura: Paraqitja Skematike te Dekantuesit dhe Basenit



- Fragmenti I Planimetrise dhe Prerjes Gjatesore te Tunelit pa Presion.




Figura: Paraqitja Skematike te Tunelit pa Presion.



- Planimetria e Godines se Hec-it.




Figura: Paraqitja Skematike e Godines se Hec-it.



d) Peshkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike

**I.Veprat e marrjes:**

**1.Vepra e Marrjes Nr.1**

Do te ndertohet ne kuoten EL.+308.5m asl,mbi lumin Kir si dhe do mbledhe edhe ujerat e disa perrenjve qe formohen gjate rrjedhes se pellgut keto se bashku me prurjet nga shirat.Vepra do te jete e re me strukture betonarme. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese, shpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit. Prurja mes eshte  $7.586\text{m}^3/\text{sek}$  ndersa prurja llogaritese eshte  $9.63\text{m}^3/\text{sek}$ . Prurja ambientale eshte  $0.758\text{m}^3/\text{s}$ .

**2.Vepra e Marrjes Nr.2**

Do te ndertohet ne kuoten EL.+307.16m asl,mbi perroin Roshit si dhe do mbledhe edhe ujerat e disa perrenjve qe formohen gjate rrjedhes se pellgut keto se bashku me prurjet nga shirat.Vepra do te jete e re me strukture betonarme. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese, shpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit. Prurja mes eshte  $1.066\text{m}^3/\text{sek}$  ndersa prurja llogaritese eshte  $1.35\text{m}^3/\text{sek}$ . Prurja ambientale eshte  $0.106\text{m}^3/\text{s}$ .

**3.Vepra e Marrjes Nr.3**

Do te ndertohet ne kuoten EL.+304.00m asl,mbi perroin e Cudit si dhe do mbledhe edhe ujerat e disa perrenjve qe formohen gjate rrjedhes se pellgut keto se bashku me prurjet nga shirat.Vepra do te jete e re me strukture betonarme. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese, shpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit Prurja mes eshte  $2.01\text{m}^3/\text{sek}$  ndersa prurja llogaritese eshte  $2.56\text{m}^3/\text{sek}$ . Prurja ambientale eshte  $0.201\text{m}^3/\text{s}$ .

**4.Vepra e Marrjes Nr.4**

Do te ndertohet ne kuoten EL.+310.30m asl,mbi perroin e Telash si dhe do mbledhe edhe ujerat e disa perrenjve qe formohen gjate rrjedhes se pellgut keto se bashku me prurjet nga shirat.Vepra do te jete e re me strukture betonarme. Punimet civile parashikojne



*[Handwritten signature]*

germime, betonime perforcuese, shpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit. Prurja mes eshte  $0.717\text{m}^3/\text{sek}$  ndersa prurja llogaritese eshte  $0.91\text{m}^3/\text{sek}$ . Prurja ambientale eshte  $0.0717\text{m}^3/\text{s}$ .

## II.Kanalet dhe tunelet e Derivacionit

1. **Kanali nga vepra e marrjes nr.1 deri ne hyrje te tunelit** ka nje gjatesi prej  $L=308\text{m}$ . Kalon ne nje bazament flishor dhe si rrjedhim marka e betonit do te jete e larte kjo per nje siguri me te plote te vepres ne menyre qe te mos kemi shkarje te vepres. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese, shpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit

2. **Hyrje e tunelit deri ne vepren e marrjes nr.2** ka nje gjatesi prej  $L=2465\text{m}$ . Seksioni tip i tunelit pa presion eshte  $(3.5 \times 5)\text{m}$  me nje trashesi te shtreses se betonit  $25\text{cm}$ . Kalon nje pjese ( $L=817\text{m}$ ) ne nje bazament flishor dhe per kete pjese do te perdoret beton i klases  $C30/37$  marka e betonit do te jete e larte kjo per nje siguri me te plote te vepres ne menyre qe te mos kemi shkarje te vepres. Nje pjese ( $L=1659.2\text{m}$ ) kalon ne bazament gelqeror . Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese me torkretim , shpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit

3. **Tuneli veper marrje nr.2 deri ne vepren e marrjes nr.3** ka nje gjatesi prej  $L=2064\text{m}$ . Seksioni tip i tunelit pa presion eshte  $(3.5 \times 5)\text{m}$  me nje trashesi te shtreses se betonit  $25\text{cm}$ . Kalon ne nje bazament gelqeror dhe si rrjedhim marka e betonit do te jete  $C 25/30$  kjo per nje siguri me te plote te vepres ne menyre qe te mos kemi shkarje te vepres. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese me torkretim , shpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes3.

4. **Tuneli veper marrje nr.3 deri ne dekantues** ka nje gjatesi prej  $L=3317.4\text{m}$ . Seksioni tip i tunelit pa presion eshte  $(3.5 \times 5)\text{m}$  me nje trashesi te shtreses se betonit  $25\text{cm}$  .Kalon ne nje bazament gelqeror dhe si rrjedhim marka e betonit do te jete  $C 25/30$  kjo per nje siguri me te plote te vepres ne menyre qe te mos kemi shkarje te vepres. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese me torkretim , shpime dhe sistemimi me



breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit se ndertimit

**5.Tuneli pa presion veper marrje nr.4 deri nehyrje te kanalit te derivacionit** ka nje gjatesi prej L=146m. Seksioni tip i tunelit pa presion eshte (2.2x3.4)m me nje trashesi te shtreses se betonit 15cm .Kalon ne nje bazament gelqeror dhe si rrjedhim marka e betonit do te jete C 25/30 kjo per nje siguri me te plote te vepres ne menyre qe te mos kemi shkarje te vepres. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese me torkretim , shpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit se ndertimit.

**6.Kanali i derivacionit deri ne hyrje te sifonit** ka nje gjatesi prej L=728m. Seksioni tip i kanalit eshte (1.2x1.0)m me nje trashesi te shtreses se betonit 15cm .Kalon ne nje bazament gelqeror ne gjatesine prej L=282m dhe si rrjedhim marka e betonit do te jete C 25/30 kjo per nje siguri me te plote te vepres ne menyre qe te mos kemi shkarje te vepres. Ne gjatesine L= 438m bazamenti eshte flishor me gelqeror te mergelizuar .Marka e betonit e do te jete e nje klasi me te larte C 30/37 kjo per arsye qe te rritet siguria e vepres. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese, shpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit se ndertimit.

**7.Sifoni** ka nje gjatesi prej L=46m. Diametri i tubacionit eshte tub celiku Ø800mm. Tubacioni do te vishet me nje shtese betoni me nje trashesi 30cm .Kalon ne nje bazament flishor me gelqeror te mergelizuar . Marka e betonit e do te jete e nje klasi me te larte C 30/37 kjo per arsye qe te rritet siguria e vepres. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese, ndertimi e nje pusete ne hyrje te sifonit me permasa ne plan (2x2)m dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit se ndertimit

### III.Dekantuesi:

Dekantuesi sherben per dekantimin e ujit nga prurjet e ngurta me madhesi me te madhe se 0.02mm. ai do te ndertohet sebashku me basenin e preonit ne kuoten 295.15. Kjo nenveper do te ndertohet me strukture betonarmeje te markes C20/25 dhe do te perballoje sasine e ujit qe vjen nga vepra e marrjes



#### **IV. Baseni i presionit:**

Baseni i presionit do te sherbej per ekuilibrin hidrodinamik dhe nivelin e ujit ne turbine. Baseni do te ndertohet ne aksin e tunelit te presionit direkt pas dekantuesit te presionit ne nivelin EL.+295.75 asl. Baseni do te kete nje dalje per furnizimin e centralit dhe nje per shkarkimin e basenit.

Ne basen do te instalohen paisjet per matjen e nivelit te ujit, dhe te matjeve te prurjeve ne tubacion, rrjetat dhe porta metalike ne hyrje te tij. Paisjet per mbylljen automatike ne rast avarie (droselat) do te instalohet ne hyrje te HEC-it.

**V. Tuneli me presion** nga baseni i presionit deri ne godinen e centralit ka nje gjatesi prej L=1000m. Ka nje diameter prej 3m dhe nga jashte do te vishet me beton 30cm. Ai krijon nje renie prej 162.75 m. Brenda tunelit eshte i vendosur tubacioni i celikut me diameter 3m. Kalon ne nje bazament gelqeror dhe si rrjedhim marka e betonit do te jete C 25/30 kjo per nje siguri me te plote te vepres ne menyre qe te mos kemi shkarje te vepres. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese me torkretim, shpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli ku te gjitha keto punime kane ndikim ne topografine e relievit por kjo eshte vetem gjate fazes se ndertimit se ndertimit.

#### **Ndertesa e hidrocentralit:**

Ndertesa qendrore e centralit do te jete me nje kat, me strukture betonarme, me mure tulle, te suvatuar ne te dy anet, me solete betonarme te hidroizoluara dhe me dritare metalike me hapesire drite 40 – 50%. Ndertesa do te permbaj keto ambiente kryesore:

- Sallen e agregateve ne te cilen do te instalohet grupet turbine-gjenerator, panelet e mbrojtjes, te eksitimit, te kontrollit, te rregullatoreve te shpejtesise, te nevojave vetjake elektrike dhe mekanike, te kompresorit te ajrit dhe impiantet hidraulike me presion te rregullatorit te ajrit dhe te vajit, vinci 5/10ton, etj.

- Sallen e elektrike ne te cilen do te instalohen panelet e matjeve, te mbrojtjes te linjes, transformatori i fuqise dhe transformatori vetjak, te celave (celsat, thikat, shkarkuesa), etj.

Ambientin e sherbimit dhe te administrates ne te cilen do te jene instaluar paisjet e kontrollit te HEC, zyra administrative dhe dhoma e sherbimeve dhe riparimeve teknike.

Nga ana tjeter, jane parashikuar punime civile qe lidhen me montimin e paisjeve te reja, zhvendosjen ose pershtatjen e bazamenteve prej betoni, etj.





### Proceset teknologjike:

Tipi i procesit qe do te kryhet ne kete veper energjitike eshte ai i sistemit hidrik per prodhimin e energjise elektrike. Sasia e lendes se pare (prurje uji) e llogaritur eshte Qllog = 14.45 m<sup>3</sup>/s. (Burime nga instituti hidro – meteorologjik).

Burime te tjera qe nevojiten per konsum jane vetem ato njerezore dhe makineri e paisje.

### Mbetjet dhe emetimet sipas tipit, sasise, perberjes dhe fortesise,perfshire:

Shkarkimet ne uje; emetimet ne ajer; zhurmat; vibracionet; ndricimi; nxehtesia; radiacioni; depozitimet/ mbetjet ne toke dhe dhera; te tjera.

Nr	Pershkrimi i mbetjes	Tipi	Sasia	Perberja	Fortesia
1	Emetimet ne ajer	Komponente kimike	Pa shifra	CO <sub>2</sub> , NO <sub>x</sub> , SO <sub>2</sub> , CO	-
2	Zhurmat; vibracionet	zhurmat; vibracionet	sdihet	Zhurma fiziko - mekanike	> 70db
3	Ndricimi	Ska	-	-	-
4	Nxehtesia	Nga transformatoret	sdihet	Vaj ne qarkullim	sdihet
5	Radiacioni	Ka	-	-	-
6	Depozitimet/ mbetjet ne toke dhe dhera	-	-	-	-
7	Te tjera	N	-	N	-

Instalimi i nje sistemi te ri te ajrosjes dhe te qarkullimit te ajrit ne brendesi te centralit, instalimi i ventilatoreve qarkullues te ajrit ne sallan elektrike, ne zbarat e daljes, etj.

- Instalimi i rrjetit te ndricimit.
- Ndertimi i aneve te mbeshtetjes te vincit (paragos) 5/10t ne sallan e agregatit.
- Instalimi i saracineskave, largimi dhe filtrimi i ujrave, etj.
- Ndertimi i kanaleve te kablove ne sallan e aggregateve, shtrimi me pllaka te reja, suvatimi dhe lyerja. Kryerja e punimeve te domosdoshme dhe modifikuese per montimin e makinerive dhe paisjeve te reja.



Handwritten signature or mark.

- *Kapacitetet prodhuese /perpunuese*

Tipi i procesit qe do te kryhet ne kete veper energjitike eshte ai i sistemit hidrik per prodhimin e energjise elektrike. Sasia e lendes se pare (prurje uji) e matur eshte rreth  $Q_{log} = 14.45m^3/s$ . (Burime nga instituti hidro – meterologjik).

Ai do te perbehet nga 2 agregate me turbine tip Francis dhe me kapacitet fuqi te instaluar  $F=19187$  Kw me nje prodhime te energjise  $E=77,428,463$  kwh/vit.

Burime te tjera qe nevojiten per konsum jane vetem ato njerezore dhe makineri e paisje.

- *Sasite e lendeve te para*

Sasia e lendes se pare (prurje uji) e matur eshte rreth  $Q_{log} = 14.45m^3/s$

- *Produktet perfundimtare te projektit qe do te zhvillohet.*

Produkti perfundimtar te projektit eshte prodhimi I energjis dhe per vitin mesatar te prurjes ka vleren  $E_{totale} = 77\ 428\ 463$ Kwh/vit.

e) *Infrastruktura e nevojshme per zbatimin e projektit.*

- *Lidhja me rrjetin elektrik.*

Ne perputhje me te dhenat ekzistuese teknike dhe shperndarjen e rrjetit elektrike, HEC-i do te lidhet me rrjetin ne nivelin e tensionit 20kv.

Per kete qellim eshte parashikuar ndertimi i nje linje 20kV qe do te lidhe Hidrocentralin Kiri 1 dhe Kiri 2, me rrjetin elektrik per te cilin kompania “**ACCESS ENERGY ALBANIA**” Shpk, ka pergatitur projekt zbatimin.

- *Furnizimi me uje.*

Furnizimi me uje te pijshem do meret nga Lumi i Kirit duke instaluar impiant pastrami.

- *Veprat kulluese ekzistuese te bujqesise.*

Ne zonen ne studim nuk ka sisteme ujitje per perdorimin e ujit te kulturave bujqesore apo perdorues te tjere te ujit.



Gjate gjithë gjatesise te derivacionit nuk ka toka bujqesore te cilat do te kene nevoje per ujitje por ne fund te tij do te vendoset baseni i presionit i cili pevec se do kete funksionimin per hidrocentralin, ai do te pajiset me nje shkarkim fundor me nje tubacion te shkurter te pajisur me saracineske me anen e te cilit do te leshohet prurja per bujqesi gjate kohes se veres kur hidrocentrali nuk do te jete ne pune. Ajo qe duhet theksuar se pervec perfitimit te energjise elektrike nga skeme e shfrytezimit perfitojne dhe banoret e zones per te cilet kane nevoje per ujitje gje e cila u mungon prej vitesh.

- *Shkarkimin e ujrave te ndotur.*  
Shkarkimi i ujrave te ndotur si jane ujerat fekal do te realizohet ne gropa septike.
- *Shkarkimi i mbetjeve.*

Pozicionet te cilat jane zgjedhur per hedhjen e inerteve te nxjerra nga germimet per ndertimin e veprave, jane zgjedhur ne menyre te tille ne vende te zhveshura, gropa te cilat kane nevoje per mbushje te krujuar keto nga levizjet tektonike dhe nuk ndikojne prishjen e pejsazhit apo te kete ndikim negativ ne mjedis po perkundrazi keto siperfaqe do sistemohen, do te rafshohen ne nivel me terenin natyral ose dhe deri disa metra me siper (kjo eshte arsyeja qe dhe lartesia mesatare e seciles siperfaqe q do te hidhen inertet del e larte rreth 13.6 m) te cilat do te mbillen bar per ruajtur njetrajtshmerine e natyres perreth. Keto inerte nuk do te hidhen ne asnje menyre ne vende ku ka gjelberime, pyje apo lloje pemesh te ndryshme ku sic dihet kjo zone eshte teper e larmishme ne shumellojshmerine e vegjatecionit.



Me poshte po japim dhe ilustrimin me foto:



**Fig.1 Grope e krijuar si rezultat e rreshqitjeve tektonike, e zhveshur, vend i cili mund te hidhen materialet nga germimet deri ne kuoten ne vijen e verdhe per te krijuar nje siperfaqe te re si ne gjendjen e hershme.**

Gjithsesi fakti qe do te kemi nje volum teper te madh dhe te konsiderueshem te dherave qe do te hidhen, jemi te mendimit qe verejtja dhe sugjerimi i dhene i nga anetari i OT per VNM qendron dhe eshte i sakte, keshtu qe plani i menaxhimit te dherave qe do te nxirren nga germimet u rishikuara, dhe me poshte po japim dhe tabelen permbledhese te shperndarjes se volumeve te materialeve.

Kemi shtuar siperfaqet per hedhjen e dherave dhe nga llogaritjet rezultoi qe kjo siperfaqe ne total te jete 62,599 m<sup>2</sup> ku ne total do te kemi 12 siperfaqe dhe lartesia mesatare e tyre do te jete rreth 4 m. Sasia e volumit te dherave per cdo siperfaqe jepet ne tabelen me poshte dhe ne harten topografike bashkengjitur me kete relacion.



Tabela e volumeve per hec Kiri 1,Kiri 2				
Nr.		sip m2	lartesi mes m	volumi (m³)
HEC KIRI 1	sip 1	5,033	4.00	20,132
	sip 1.1	21,422	3.38	72,434
	sip 2	1,905	4.00	7,620
	sip 3	1,905	4.00	7,620
	sip 4	1,193	4.00	4,772
	sip 5	1,890	4.00	7,560.00
HEC KIRI 2	sip 1	3,314	4.00	13,256.00
	sip2	7,073	4.00	28,292.00
	sip 3	3,172	4.00	12,688.00
	sip 4	8,900	4.00	35,600.00
	sip 5	5,081	4.00	20,324.00
	sip 6	1,712	4.00	6,848.00
<b>Totali m³</b>		<b>62,599.63</b>		<b>237,146</b>

## LIGJ

Nr. 111/2012

### PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE<sup>2</sup>

Neni 84

#### Veprimtaritë në brigje

Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet:

- një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit;
- një sipërfaqe toke e lirë për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, me gjerësi nga 100 m deri në 200 m.

Persa i perket ceshtjet te distances se hedhjes se dherave, nga vija e lumit apo perrenjeve, eshte nja nga problemet kryesore per projektin e HEC-ve te KIRIT sepse vete kushtet topografike dhe rrjeti hidrografik i dendur krijon pak alternativa te siperfaqeve te tilla. Por gjithsesi ne zbatim te ligjit te mesiperm siperfaqet e zgjedhura per hedhjen e meturineve jane zgjedhur ne menyre te tilla qe t'u pergjigjet normave.



Keto distanca variojne nga 100m deri ne 150 m., por edhe ne ato vende ku thyhet kjo distance nuk perben problem sespe keto vende jane gropa tektonike te cilat kane nevoje per mbushje sidomos sipërfaqja 1.1 e treguar ne hartën topografike bashkëngjitur me kete rekacion. Keto materiale nuk do te hidhen ne afersi te grykave te lumit Kir gje cila ndalohet dhe me ligj po ne ato pjese ku lugina zgjerohet, ne zona te zhveshura pa bimesi.

- *Informacion per rruget egzistuese dhe nevojen e hapjes se rrugeve te reja.*

Gjate perzgjedhjes se skemes perfundimtare te shfrytezimit hidroenergjitik te HEC KIRI 1 eshte menduar qe planvendosja e veprave te minimozoje rruget e gjata te aksesit per ndertimin e tyre, ne menyre te tille qe te eliminohen dhe demtimet ne mjedis. Hec kiri 1 shtrihet ne pjesen e mesme te pellgut ujembledhes me drejtim nga veriu ne jug, nga fshatit Kir ku ndodhet vepra e marrjes nr.1 e deri ne fshatin Ura e Shtrenjte. (Shih hartën topografike). Ne kete menyre kjo zone ka infrastrukture shume te mire e cila ndihmon per te hyre ne veprat perberese te HEC-it si nga ana veriore, nga vepra e marrjes se ujit edhe nga jugore godina e HEC-it.

Keshtu qe eshte menduar qe trasete qe do te hapen per shtrijen kanaleve dhe te tubacioneve te presionit do te perdoren si rruge aksesit per te ndertimin e vepres. Ne rastin e hidrocentralit Kir 1 te gjitha veprat jane shume afer rrugeve ekzistuese dhe ato do te perdoren per kalimin e makinerive te nevojshme per ndertimin e e veprave.

Ne kete pjese nuk do kete rruge aksesit te cilat do te hapen per ndertimin e vepres

(shih hartën topografike). Rruget me ngjyre te verdhe dhe kafe jane rruge ekzistuese, me ngjyre blu jane tunelet qe do te hapen, ndersa me ngjyre te kuqe jane rruge ekzistuese por qe ne disa vende (mes sakt ne dy pozicione me gjatesi 4- 5m, ku ne total shkon 10 ml. Ne kete pjese rruga eshte e gjere rreth 2.5-3 m dhe mendohet qe gjersia e saj te çohet deri ne 4m per te mundesuar levizjen e lirshme te mjeteve) ka nevoje per zgjerim per kalimi e makinerive punuese.






Fig.2 Harta topografike e zones te planvendosjejs se veprave HEC “KIR. 1”.Me ngjyre te verdhe dhe kafe jane rruge ekzistuese, me ngjyre blu jane tunelet qe do te hapen, dhe ngjyre te kuqe jane rruge e reja kane nevojje per zgjerim ne 10 ml (1.2 km gjatesi rruge nga vepra e marrjes nr.1 deri ne vepren e marrjes nr.4).



Y



**Fig.3 Pamje e rruges aktuale hyrese per ne zone vepren marrjes nr.1(kryesore) te HEC "KIRI 1"**

Sic shihet dhe nga skema e zgjedhur kryesisht veprat e transportimit te ujit nga vepra e marrjes nr.1 deri ne godine do te behen me tunel te cilet kane prerjet terthore si me poshte si ne rastin kur kemi tunel pa presion (tuneli i kanalit te derivacionit) dhe ate me presion (i tubacionit te turbinave) te cilat do te sherbejne dhe si rruge aksesu gjate fazes se ndertimit por dhe operimit te vepres.








Fig.4.Seksioni tip i tunelit me presion






Fig.5.Seksioni tip i tunelit me presion.

Si rruge te reja do te hapen 1.2 km te tilla te cilat edhe keto do te sherbejne si trase per hapjen e kanalit gjate fazes se ndertimit por edhe gjate fazes se operimit nga vepra e marrjes nr.1 deri ne vepren e marrjes nr.4. (shih harten topografike me siper).Ne kete segment kanali i derivacionit do te shtrihet ne krahun e djathte te kunderrjedhes se lumit Kir, ku kemi te bjeme me nje gjeresi lugine ku ka hapsire per te ndertuar si kanal in edhe rrugen e aksesit ne krah te tij. Edhe kjo rruge do te jete e perhershme mqs ajo eshte gjysme e hapur ne menyre natyrale, e cila do te sherbeje per kalimin e mjeteve ne rast avariën ne vepren e marrjes nr.4.






Fig.6.Prerje terthore tip e marre nga projekt-zbatimi i kanalit te Hec "Kirit 1" nga vepra e marrjes nr.1 deri ne vepren e marrjes nr.4.

Pra perfundimisht te gjitha rruget e hapura si ne forme tuneli apo ne forme rruge ne krah te kanalit te jen te perhershme dhe do te shoqerojne vepren gjate gjithe jetegjateise se saj.





- *Kohezgjatja e planifikuar per funksjonimin te projektit.*

Kontrat e koncesionit eshte 35 vjete

- *Faza e planifikuar per rehabilitimin e siperfaqes pas mbarimit te projektit.*

Investimet e parashikuara per rehabilitimin e zones

Firma aktualisht pretendon te kryeje investime per vete aktivitetin qe ka. Investimet e saj do te jene ne kuadrin e mirembajtjejs se mjeteve dhe blerjen e projektit te shfrytezimit si dhe pergatitjen e dokumentacionit ligjor per marrjen e "Lejes Shfrytezimit".

Parashikimi i realizimit te prodhimit vjetor ne objekt

Per shfrytezimin e Lumit te Kirit , do te perdoret sistemi i prodhimit te energjise elektrike me derivacion. Zona e percaktuar per shfrytezim dhe kerkuar nga subjekti ndodhet ne lumin e Kirit (Komuna Pult, Rrethi Shkoder). Siç e kemi theksuar me siper shfrytezimi i lumit behet i domosdoshem per faktin se erozioni natyror ushtron veprimtari gerryese ne shpatin perendimor duke eroduar siperfaqe te konsiderueshme tipike pyjesh.

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale e projektit teknik, shfrytezimin e kemi konceptuar ne dy faza:

#### **Faza e pare.**

Pergatitjen e raportit te fizibilitetit, dhe marrjen e koncensionit per shfrytezimin e lumit te Kirit per HEC me derivacion ( shif projektin dhe harten).

#### **Faza e dyte.**

Ndertimi i vepres hidroenegjitike, shfrytezimin e tij dhe prodhimin e energjise elektrike.

Bazuar ne kerkesen e vete subjektit, rezervave te shfrytezueshme, kapacitetit prodhues te HEC-eve, prodhimi vjetor ne objekt eshte parashikuar **Etotale= 77 428 463 Kwh.**

Mbetjet e prodhimit do te depozitohen e rihidhen në objekt per te frenuar gerryerjen e metejshme te shpatit.

#### **Organizimi**

Objekti do te jete nen administrimin e kompanise "**ACCESS ENERGY ALBANIA**" Shpk.

Ai do te kete ne perberje drejtues teknike e mekanike.

Ne HEC-e do te punohet me turne, dhe puna eshte teresisht e mekanizuar.



**Masat për rigjenerimin e sipërfaqes gjatë dhe pas shfrytëzimit**

1. Krijimi i sipërfaqes për mbjellje te reja e gjelberime.
2. Sistemimin e materialit të mbulesës dhe të sterileve që dalin gjate ndertimit.
3. Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidane shelgu, plepi, akacie.
4. Mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella.
5. Sistemimin e brigjeve anësore.
6. Mbjellje fidanesh të rinj.

Në vitin e parë dhe në çdo vit në vazhdim do të mbillen rreth 500 fidane plepi dhe shelgu.

**Gropat do të hapen me përmasa 80 x 80 x 80 cm.**

Hapje gropash	500 copë x 100 lekë/copë	50 000 lekë
Blerje fidanash, transport etj.	500 copë x 100 lekë/copë	50 000 lekë
Mbjellje, plehërim	500 copë x 50 lekë/copë	25 000 lekë
<b>Totali i preventivit</b>		<b>125 000 lekë</b>

Grumbullimi i dheut aktiv në sipërfaqe të vepres

Volumi i dheut qe do te levizet eshte 192 482 m3

Transporti dhe sistemimi 192 482m3 x 70 lekë/m3 = 13473740lekë

Sasia e dheut të kërkuar do merret nga grumbullimi i dherave të nxjera gjatë ndertimit.



Preventivi përmbledhës për rigjenerimin e mjedisit

Emërtimi	Vlefte në lekë
Mbjellje fidanesh të rinj	125 000
Grumbullimi i dhëut aktiv	325 000
Totali i preventivit për një vit	450 000
Kosto për rigjenerim / 1Kwh prodhim	0. 043

- 1- Mbjelljen e siperfaqeve te shfrytezuara të shkalleve me bime e peme.
- 2- Sistemimi i sterileve.
- 3- Mirembajtjen e siperfaqeve te mbjella.
- 4- Sistemimin e skarpateve para e pas shfrytezimit.

1. Mbjelljen e siperfaqeve te shfrytezuara të shkalleve me bime e peme.

Theksojme qe siperfaqet qe do te germohen per shkak te vendosjes se tubacioneve apo kanaleve jane zgjedhur ne menyre te tille per t'ju shmangur pyjeve dhe kullotave. Sic theksuam me siper HEC KIRI pervec veprave te marrjeve, dekantuesit, basenit dhe godines se HEC-it qe jane ne siperfaqe pjese tjeter e veprave jane ne tunele (kanalet e derivacionit dhe tubacioni me presion).

Veprat qe do ndertohen ne siperfaqe do vendosen ne zona te zhveshura, pa interes publik, toka shtereore me bimesi te rralle ku siperfaqja e tyre shkon rreth 3200 m2, nga keto vetem 200m2 do te shkelen ne vende te gjeleberuara me peme te cilat jane menduar te rimbillen serisht. Kjo siperfaqe prej 200 m2 qe do demtohet, eshte llogaritur se net do te mbillen rreth 100 fidane (si shelg,plep) etj.

Kemi thene qe inertet do te hidhen ne 11 pozicione te tilla dhe siperfaqja e tyre totale do jete sipas llogaritjeve te mesiperme rreth 62 599 m2, dhe normalisht eshte siperfaqe relativisht e madhe, por sic kemi theksuar me siper keto dhera do te hidhen ne vende ku nuk ka peme, zonat zhveshura, gropa te shkatuara nga veprimet tektonike, zona pa interes publik. Pas hedhjes se ketyre materialeve siperfaqja e zene do te mbillet me bar, si terfili dhe troska, pa prishur dhe njetrajtshmerine natyrale te zones perreth.

**Perfundimisht ne kemi thene qe do te mbjellim 500 fidane ne cdo vit per 10 vjet qe ne total i bie rreth 5000 fidane per te gjithë zonen e perkthyer kjo ne siperfaqe / bie rreth 2500 m2, dhe kemi arritur ne kete perfundim, se keto fidane do te mbillen rreth godinave te HEC-ve, dhe rreth veprave te tjera apo ne pjese te ndryshme te terrenit**



ku mendohet se do kete rreshqitje te shpateve, per siguruar si vepren edhe rruget ekzistuese, por brenda ketij plani natyrisht qe futen dhe fidanet qe do prishen apo shkulen si rezultat i nevojese se punimeve qe kemi thene mesiper e perkethyer ne siperfaqe eshte rreth 200 m2.

Pra, e thene perfundimisht jo e gjithe siperfaqja qe ne do te perdorim per ndertimin e vepres do te jete e mbjelle (62.6ha + 1.54 = 64.14ha), por nje pjese e saj ne ato raste kur nuk ka mundesi te tjera qe jemi te detyruar te prishim me patjter fidane, eshte menduar qe kjo siperfaqe relativisht e vogel rreth 200 m2 .

## 2. Sistemimi i sterileve

Sistemimi i mbetjeve teknologjike sic theksohet me siper do te behet ne sheshin qe do te krijohet ne fazen e ndertimit dhe me pas kur te filloje sistemimi I skarpateve do te merret e do te depozitohet ne ane te shtratit te vepres per te realizuar kijimin e shtresave vegjetale e mbjedhjen e pemeve per mbrojtjen nga erozioni I metejshem. Volumi I sterileve qe do te krijohen eshte 4600m3.

## 3. Mirembajtja e siperfaqeve te mbjella

Ajo do te realizohet nga subjekti. Mund te ngrihen prita per te perforcuar mbrojtjen e pyjeve nga erozioni ne zonat reth karieres. Gjithashtu do te kujdeset per mbareshtimin e pemeve qe do te mbillen nga shoqeria. Per kullimin e ujrave qe do te grumbullohen ne sheshin e depozitimit te sterileve do te hapet nje kanal per drenimin e ujrave jashte sheshit te depozitimit .

## 4. Sistemimi i skarpateve para e pas shfrytezimit

Subjekti ka per detyre e do te realizoje sistemimin e mirembajtjen e skarpateve te shkalleve ku aktualisht ai eshte i shkaktuar nga ndertimi. Ato do te mbahen nen vezhgim gjate gjithe kohes se shfrytezimit e me pas saj deri ne mbareshtimin e pyllit. Skarpatet do te mbushen me material steril, do te perforcohen me trungje e do te hidhen dhera te mbuleses mbi to. Mbase te jete lidhur toka do te filloje mbjedhja e pemeve.

g) *Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit.*





### ***Pastrimi dhe pergatitja e sheshit***

Traseja neper te cilen do te ndertohen kanalet e marries dhe do te shtrihet linja e tubacioneve ka shume pak, ose aspak vegjetacion te ulet. Asnje dru nuk do te pritet qe eshte jashte trasese se ndertimit te kanaleve dhe shtrimit te tubacioneve te Hec Kiri 1.

Te gjitha paisjet qe do te kerkohen te perdoren dhe sjellin zhurma me te medha duhet te kufizohen ne oret e funksionimit, sipas situates perreth. Ne ditet qe ato do te perdoren do te synohet te kete nje numer minimal te punonjesve ne trasene e kanaleve dhe te tubacioneve.

### ***Konflikti me perdorimin aktual te tokes si toke bujqesore***

Nuk do te merret toke me qira per trasene e kanaleve dhe te tubacioneve, meqenese punimet do te jene kryesisht pergjate shpateve te maleve dhe ne shtratin e Lumit te Kirit.

### ***Shqetesime te ndryshme pe mund ti shkaktohen komuniteteve tokale***

Te gjitha lejet duhet te merren nga autoritetet e komunitetit dhe nese perkohesisht preken siperfaqe toke, ato pas perfundimt te punimeve duhet te kthehen ne gjendjen fillestare.

### ***Vendosia e veprave hidroteknike dhe e godines se hidrocentralit.***

Nderhyrjet ne toke, gjate hapjes se kanaleve dhe per shtrimin e tubacioneve te dergimit te ujit ne hidrocentral, pritet te sjellin shqetesime te ndryshme.

Gjeresia e trasese se kanalit te vepres qe do te hapet te jete minimale per te zvogluar demtimin e siperfaqes se tokes dhe te sasise se dherave te germuara.

### ***Magazinimi dhe trajtimi i materialeve te rrezikshme***

Duhet treguar kujdes per te evituar ndotjen e tokes dhe ujit nga pikimet dhe rrjedhjet e mundeshme te lubrifikanteve dhe solventeve qe do te perdoren gjate ndertimit te vepres. Nje plan emergjence duhet te pregatitet ne rast te rrjedhjeve te lubnifikanteve dhe solventeve.

*Hedhja e mbeturinave te ngurta dhe te lenget* Problemet shqetesuese qe lidhen me ndotjen e mjedisit jane dhe mbetjet e ngurta qe do te gjenerohen gjate ndertimit te vepres hidroteknike. Keto mbetje do te duhet te hidhen ne vende te caktuara nga pushteti lokal.

### ***Problemet shqetesuese ne lidhje me kontaminimin e ujit***

Nuk do te lejohet hedhja e mbetjeve te ngurta apo te lengeta ne mjedis te hapur dhe ne vijat ujore.



h) *Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materjale ndertimi, uji dhe energji)*

Lenda e pare qe do perdoret per ndertimin e objektit hec-it KIRI 1 jane:

- 1.Cakull ose zhavor lumi.
- 2.Rere.
- 3.Hekur.
- 4.Material rrethanor.qe sherben per mbushje dhe sistemimin e shesheve.

Sigurimi i materialeve realizohet me transport per ne objekte.

i) *Informacion per lidhjet e mundeshme te projektit me projektet e tjera prane projektit tone.*

j) *Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret.*

Si vende te ngjashme te marra ne konsiderate jane Hec – Smokthine ne Vlore, Hec – Gjancit ne Korce, Hec – i Bogoves (Skrapare), Lekbibaj (Tropoje) etj ku ish sistemet vaditese qe sherbenin per bujqesine ne periudha te caktuara gjate vitit perdoren per prodhimin e energjise elektrike por pa nderprere apo prishur regjimin ujqor te aktivitetin ekzistues.

k) *Perdorimi i lendeve te para gjate funksjonimit si: Sasia e ujet te nevojshem , energjine, lenda djegese dhe menyren e sigurimit te tyre.*

Sasia e lendes se pare (prurje uji) e matur eshte rreth  $Q_{\text{lllog total}} = 14.45\text{m}^3/\text{s}$

l) *Aktivitete te tjera qe mund ti nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertimi i kampeve dhe rezidencave.*

Per zbatimin e projektit do ndertohen kampe me kontenjer qe do jene kontejner shërbyese për objekte ndërtimore.

m) *Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin e kerkuar, nga ligjislacionit ne fuqi si dhe institucionet ne fuqi si dhe instutucionet kompetente perlejimin , licensimin e projektit.*



### **Korniza kryesore e kuadrit ligjor per pergatijen e ketij Raporti te VNM-se:**

Persa i perket bazes ligjore, referuar Fletores Zyrtare te Republikes se Shqiperise e cila eshte botuar nga Qendra e Botimeve Zyrtare, per ligjin nr 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" jane perpiluar 101 nene nga te cilat kemi shkeputur disa prej tyre te cilat kane lidhje te drejtperdrejte me VNM te HEC-ve.

### **Legjislacioni I fundit Shqiptar**

Ndergjegjesimi ne Shqiperi eshte i nje niveli te ulet, kjo si rrjedhoje e nje legjisiaciani mjedisor relativisht te ri qe eshte ne zhvillim dhe po plotesohet me tej sidomos me rregullore dhe standarte.

Aplikimet per VMM kane si detyrim paketen ligjore te meposhteme:

- Ligji 111/2012, date 15.11.2012 'Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore'
- Ligji 10448, date 14.07.2011 "Mbi lejet mjedisore"
- Ligji Nr. 10431, dae 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit"
- Ligji 10440, date 7.7.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"
- Ligji 10463, date 7.7.2011 "Per vmenaxhimin e integruar te mbetjeve"
- Ligji 8906, date 06.06.2002 "Per zonat e mbrojtura" i ndryshuar
- Ligji 10006, date 23.10.2008 "Per mbrojtjen e faunes se eger"
- Ligji 9587, date 20.07.2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji 9385, date 04.05.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor" i ndryshuar.
- Ligji: " Per token", Nr.7501 date 27.01.1995.
- Ligjin Nr. 7973,dt,26.07.1995 "Per konçensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat ne sherbimet publike dhe infrakstruktures" ndryshuar me ligjet Nr. 8105,dt 28.03.1996, Nr.8329,dt.16.04.1998 dhe dekretin nr. 1628.dt.17.10.1996.
- VKM Nr 13, date 04.01.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis"
- Udhezimi Nr 3, date 02.12.2013 "Per dokumentacionin e lejeve mjedisore"



## LIGJI Nr. 111/2012

### PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE

#### Neni 1

#### **Qëllimi**

Ky ligj ka si qëllim:

a) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre;

b) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit;

c) shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre;

ç) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike;

d) përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave sociale dhe ekonomike të vendit.

#### Neni 2

#### **Fusha e veprimit**

1. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë marrëdhëniet juridike që lindin nga përdorimi i burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:

a) ujërat brendshme detare, ujërat territoriale, vijën bregdetare, zonën ekonomike ekskluzive, shelfin kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike, ujërat ndërkufitare, burimet natyrore dhe ujërat e lagunave e zonat e mbrojtura;

b) ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, me përjashtim të ujërave minerale dhe gjeotermale që janë të përshtatshme për nxjerrjen e lëndëve të para minerare ose shfrytëzimin e energjisë termike të akumuluar për qëllime të prodhimit të energjisë, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.

#### Neni 3

#### **Objekti i ligjit**

Dispozitat e këtij ligji kanë si objekt të përcaktojnë:

a) sigurimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të burimeve ujore;

b) zbatimin e planeve konkrete për përmirësimin e burimeve ujore, mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore, të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme



detare, zonës ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore dhe të statusit të tyre;

c) promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit nëpërmjet mbrojtjes afatgjatë të burimeve ujore;

ç) zbatimin e metodave dhe kushtet për menaxhimin e integruar, përdorimin racional të burimeve ujore e mbrojtjen e cilësisë ekologjike të tyre;

d) krijimin e strukturave administrative për menaxhimin e burimeve ujore, si dhe ushtrimin e funksioneve të tyre;

dh) marrjen e masave për zbutjen efektive të përmblytjeve dhe thatësirave;

e) monitorimin e statusit të ujërave, përdorimin racional dhe pakësimin e ndotjes;

ë) parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm, mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së brigjeve, të ekosistemeve tokësore dhe ligatinave që varen drejtpërdrejt nga ekosistemet ujore.

Persa i perket me siper ligji pershkruan qarte se cilat jane kushtet dhe normat qe duhen plotesuar gjate fazes se ndertimit dhe operimit te hidrocentraleve, ku investitori eshte I vetedijshem per te mare masa per sigurimin, mbrojtjen dhe shfrytezimin racional te burimeve natyrore, perdorimin e qendrueshem te ujit nepermjet mbrojtjes afatgjate gjate gjithë periudhes se koncensionit, pakësimin e ndotjes dhe zbatimin e metodave per mbrojtjen e cilesise ekologjike te burimeve natyrore.

**Ligji Nr. 8934 datë.05.09.2002: “Për mbrojtjen e Mjedisit”i ndryshuar me Ligjin Nr.9890,**

datë 20.03.2008; Ligjin Nr.9983, datë 08.09.2008; Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009

**Ligji nr.8990 datë 23.01.2003, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar me Ligjin Nr.10 050, datë 24.12.2008.**

**Ligji nr.8905 date 06.06.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe demtimi” i Ndryshuar.**

**Vendim nr.3 date 21.06.2006 “Per rehabilitimin e shtreterve dhe te brigjeve te lumenjve , te demtuara nga shfrytezimi i inerteve”**

**3) Nje pershkrim i analizes te zbatimit te projektit dhe elementeve te vecante te tij , si dhe arsye per alternative e zgjedhur duke marre parasysht ndikimet ne mjedis te seciles alternative.**



Per ndertimin e ketij hidrocentralido te ndertohen keto vepra:do te realizohen germime, ndertim dhe shtrimin te tubacioneve, perdorim te makinerive germuese dhe transportuese, etj.

Pra gjate kryerjes se ketyre operacioneve do te kete krijim te pluhurave ne sasira te vogla si rezultat i punimeve te ndryshme qe duhen bere ne te.

**-Ndikimet ne mjedis gjate pregatitjes se vepres marries dhe transmetimit te ujit ne Hec-it.**

Nje ndikim ne mjedis ka edhe pergatitja e veprave hidroteknike te ketij objekti. Per shkak te punimeve te germimit do te kemi emetim pluhuri ne sasira te vogla si rezultat i punimeve te ndryshme qe duhet te behen.

Per te bere te mundur reduktimin ne minimum te pluhurave gjate transportit eshte e domosdoshme qe makina transportuese te lagen dhe te mbulohen.

**-Ndikimet ne mjedis gjate largimit te materialeve qe do te largohen nga linjat e shtrirjes se tubacioneve, etj**

Terreni malor neper te cilin do te kalojne tubacionet e dergimit te ujit per ne hidrocentral, tregon se kemi te bejme me shume germime. Pjesa me e madhe e materialeve te germimit nuk eshte nevoja te largohen, pasi do te perdoret per te sistemuar dhe mbushur terrenin perreth. Megjithate nje sasi e vogel dheu i germuar do te largohet nga sheshi dhe duhet te depozitohet ne vende te caktuara. Pikerisht pushteti lokal duhet te caktoj vendin e pershtatshem ku do te depozitohen pa shkaktuar ndotje te tjera ne mjedis.

**Ndikimet ne mjedis si rezultat i sjelljes se materialeve te ndryshme per ndertimin e veprave hidroteknike te hidrocentraillt.**

Megjithese kemi te bejme me germim veper marrje,dekantues dhe basenin e presionit do te kemi volume te konsiderueshme materialesh ndertimi (rere, cakull, beton, tuba, etj.) qe do te sillen per betonimin nepermjet makinave te tonazhit te larte, te mesem dhe te vogel sipas rastit. Te gjitha keto makina do te rrisnin trafikun dhe nivelin zhurmave.

**4) Nje pershkrim i gjendjes dhe i vlerave egzistuese te mjedisit qe mund te ndikohen nga zbatimi i projektit te propozuar.**



#### 4.1 Pershkrimi i karakteristikave fizike te zones se projektit

- *Pershkrimi i faktoreve klimaterik.*

Duke u bazuar në ndarjen klimatike të vendit tonë, territori përreth vendit ku do të ngrihet Hidrocentrali "KIRI 1 i takon rrethit të Shkodresit dhe përfshihet në zonën klimatike mesdhetare malore e që shtrihet deri në lartësi ndërmjet 600 -2400m mbi nivelin e detit dhe në Zonën Klimatike Mesdhetare Malore (në zona Malore qendrore në kahun e lindjes).

- *Pershkrimi gjeomorfologjik dhe i sizmicitetit i zones.*

Gjeomorfologjia e zones ku do të ndërtohet HEC-i KIRI 1 është tepër komplekse, me lartësi para – malore dhe perrenj të fuqishëm, ku të gjithë këta së bashku derdhen në lumin Drin pranë Kalasë së Shkodrës.

Përsa i përket sizmicitetit sipas Rajonizimit sizmik të Shqipërisë Harta e Rajonit Sizmik shk. 1:500.000, miratuar me vendim të K.M. të Shqipërisë Nr.371, dt.20.12.1979, rajoni ku do të ndërtohet hec-it KIRI 1 në zonën sizmike me intensitet 8 balle.

- *Pershkrimi gjeologjik dhe tokës në vendin e zbatimit të projektit.*

Në kuadrin e studimit të skemës energjitike të Lumit të Kirit u krye studimi mbi kushtet Gjeologjiko-Inxhinierike të Hidrocentralit KIRI 1 i cili do të ndërtohet me konçesion në Lumin e Kirit në Rrethin e Shkodrës.

Studimi u krye:

- Me vëzhgime dhe dokumentime në terren
- Me shfrytëzimin e materialeve arkivore
- Për këtë studim u shfrytëzuan edhe studimet e kryera për skemën Energjitike të lumit të Kirit.

Bazuar në sa u tha më lart, rezulton se kushtet Gjeologjiko-Inxhinierike të Hidrocentralit KIRI 1 janë si më poshtë.

Zona ku do të ndërtohet hidrocentrali në Lumin e Kirit gjeologjikisht bën pjesë në pjesën e madhe strukturorë-tektonike "Mirdita".



Ne kete zone takohen keto formacione gjeologjike:

- a) –shkembinjte ofiolito-jurasik ( $\sigma$ J2-3)
- b)-formacionet gjysem shkembore paleogjenike (Pg22)
- c)-formacionet gjysemshkembore neogjenike te suites se Shkodresit.

- *Pershkrimi i ujrave sipërfaqesore dhe nentokesore te zones*  
Ujerat sipërqesor perbehen nga ujerat e Lumit te Kirit dhe nga deget qe formohen nga shpatet e thepisuar te lugines se Kirit.  
Ujerat nentokesor ndodhen ne sipërfaqen e lugines te Kirit dhe niveli i tyre rritet ne pranimin e reshjeve sepse mbulesa argjilore e shtresave mbrojtese ne kete zone eshte e vogel.

#### **4.2 Pershkrimi i biodiversitetit ne zonen ku zbatohet projekti.**


- *Pershkrimi i habitateve kryesore ne zonen e projektit dhe harta ilustruese.*

#### **Flora dhe fauna:**

Ekosistemet, habitatet dhe pejsazhet ekzistuese, statusi i mbrojtjes se tyre (i mbrojtur, vecanerisht i mbrojtur) dhe statusi i ruajtjes (i favorshem, i pafavorshem)







Handwritten signature or mark.

## Flora.

Zona ku eshte parashikuar per te ndertuar objektin, ne afersi ka bimesi tip dushqesh, vende vende deri ne te drunjte.

I gjithe peisazhi fiton nje pamje ku dominancen e zoterojne dushqet. Dushqet mbizotërohen nga qarri (*Quercus cerris*) me shkurret e shkozës (*Carpinus sp.*), lajthisë (*Corillus avellana*), dëllinjës (*Juniperus sp.*) dhe shpesh bushit (*Buxus sempervirens*). Në drejtim të lindjes shkurret mesdhetare bëhen më të rralla, dhe llojet gjithnjë të blerta zëvendësohen nga llojet gjetherënëse. Më kryesorët e këtij brezi janë mareja (*Arbutus unedo*), shqopa (*Erica arborea*), driza (*Paliurus aculeatus*), dëllinja (*Juniperus sp.*) etj.

## FAUNA

- a. **Perberja ne lloje ekzistuese dhe statusi i mbrojtjes se tyre (i mbrojtur, veçanerisht i mbrojtur, i rralle, i kercenuar, endemik) dhe statusi i ruajtjes (i favorshem, i pafavorshem).**


### Fauna e Egër

Zona e Kirit përbën një tërësi me mjaft rëndësi për faunën e egër duke përfshirë, insektet, peshqit, reptilët, shpendët dhe gjitarët. Deri tani janë raportuar rreth 27 taksone gjitarësh, 280 lloje insektesh, 10 amfibë, 17 reptilë, dhe disa lloje peshqish, dhe 167 lloje shpendësh.

### Gjitarët

Zona në shqyrtim është vend jetese për mjaft gjitarë gjërisht të kërcënuar në Evropë. Janë regjistruar rreth 27 lloje gjitarësh si të pranishëm në rajon edhe pse këtu mungojnë kërkimet përkatëse sistematike cilësore dhe sasiore. Në tërësinë e *mammalofaunës* takohen llojetë rëndësishëm si ariu, ujku dhe rrëqebulli (për zonën më gjërë). Në mes të 27 llojeve të gjitarëve 9 prej tyre janë lakuriq nate, 3 insektivorë, 7 rodentë, 5 karnivorë, 2 *artiodactyla* dhe 1 lloj lepuri.

Shtatë prej 27 llojeve të gjitarëve trajtohen si globalisht të kërcënuar ose te rezikuar (*Rhinolophus ferrumequinum*, *R. blasii*, *R. hipposideros*, *Miniopterus schreibersi*, *Myotis capaccinii*, *M. myotis*, *Canis lupus*).



**Tabela 1. Rëndësia e zonës përreth, për 5 lloje të veçanta të gjitarëve**

**(Burimi Pyjet e Virgjër te Shqiperise, EB 1997).**

Zona pyjore	Ariu	Ujku	Rreqebulli	Dhie eger	e Kaprolli
	Nivel ne rritje	Nivel ne rritje	Nivel ne rritje	Nivel ne rritje	e ulet

**Shpendët**

Avifauna e ekosistemeve ujore e terestiale të zonës ofron një larmi biologjike të lartë me rreth 167 lloje shpendësh. Gjithashtu karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmaeus*) shumëzohet dhe dimëron në rajonin e gjërë të marë në konsideratë.

**Fauna akuatike**

Studimet istiolgjike për ujrak e brendshme, (sidomos për lumenjtë) kanë qënë të pakta. Referenca për peshqit e lumit te Kirit është e papërfillshme. Të dhënat e para jepen në publikimet e mëparshme të Çake et al, të cilat ndër të tjera marrin në shqyrtim edhe ndotjen e mjedisit.

Llojet e gjetura, u takojnë rendeve: *Anguilliformes*, *Cypriniformes*, *Mugiliformes* dhe *Clupeiformes*, ku familja *Cyprinidae* është dominuese me 12 lloje, ose rreth 70.58 % të llojeve të gjetura; grupet e tjera janë të përfaqësuar vetëm nga një ose dy lloje.

- a. Te drejtat per te perdorur perberesit e biodiversitetit duke perfshire dhe perdorimet tradicionale te popullatave lokale.**

**Mikroalgat**

*Mikroalgat* janë një grup heterogjen arbitrar ku përfshihen të gjithë organizmat bimorë njëqelizorë ose kolonialë që popullojnë pjesën e ndriçueshme të mjedisve ujorë të kapur në fund mbi substrate të ndryshme (fitobentosi) ose duke qëndruar pezull në ujë (fitoplanktoni). Në këtë kategori ka shume grupe por më të rëndësishmet nga ana llojore dhe ekologjike janë diatometë (*Bacillariophyceae*), peridinetë (*Dinophyceae*), kokolitoforidet (*Chrysophyceae*), klorofitet (*Chlorophyceae*) dhe algat blu të gjelbërta



(*Cyanophyceae*). Këto organizma janë prodhuesit parësorë dhe përbëjnë nivelin e parë ushqes në këto mjedise.

Keto habitate zhvillohen shumë në fundin e pranverës dhe gjatë verës, ndërsa në dimër arrihet minimumi i tyre. Llojet e gjetura u përkasin ujërave përgjithësisht të ndotura-*mezosaprobe*, me lëndë organike të lartë, oksigjenim mesatare, që karakterizohen për shumëllojshmëri të lartë të bimëve dhe kafshëve mikroskopike, dhe janë të përshtatshme për peshkim, sidomos ciprinide.

- *Pershkrimi i vegjitacionit ne secilin habitat dhe statusi i ruajtjes kombetare dhe nderkomtar i tyre*

### **Mjedisi Tokësor dhe Ligatinor**

Karakteristika kryesore e zonës së marë në shqyrtim është se në një territor shumë të vogël takohen lloje të ndryshme ekosistemesh duke përfshirë ato malore, lumore, të ujrave të ëmbëla (e rezervuarë), si dhe ekosisteme bujqësore ose agro ekosisteme. Zona në të dy anët e Lumit të Kirit tipizohet për nga larmia morfologjike si dhe procese aktive të depozitimit të sedimenteve dhe grumbullimit, një rrjet interesant hidrologjik dhe sedimente fine që transportohen në shtratin e gjërë.

Vegjitacioni tokësor në këtë zonë i përket kryesisht karakterit të Europës Qendrore Kontinentale, me prani të pak elementëve mesdhetarë. Formacionet bimore të tërësisë tokësore shprehin një larmi formash, duke u zhvilluar ne mjediset e ulta afër ujembledhesve dhe Perrenjve ku sistemet e kulturave bujqësore dominojnë, në rajonet me lartësi të mesme e të madhe, e deri ne zonat e kullotave alpine.

Në fushat e ulëta dhe kodrat, janë përshkruar një larmi formash barishtore si më poshte vijon: vegjitacioni i barishteve të këqija ndaj kulturave bujqësore, *vegjitacioni nitrofil*, dhe *vegjitacioni anash rrugor*, *vegjitacioni amofil*, i kullotave të ulta e kodrinave, vegjitacioni i livadheve mocalore, dhe vegjitacioni i sistemeve pyjore.

Duke u mbështetur në vëzhgimet e deritanishme, ekosistemet natyrore të kësaj zone përbëhen nga një tërësi nën habitatesh si ato të sistemeve të përhershme ujore, të kanaleve kullues e ujitës, ekosistemeve të rezervuareve, bankinave të sistemeve rrjedhëse ujore etj.



Ekosistemet tokësore të zonës i përkasin nën ndarjes ballkanike të zonës së vegjetacionit Sub-Mesdhetar. Këtu mund të vecohen tre nënzona fitoklimatike, si më poshtë:

- zona e dushkut,
- zona e shkurreve
- zona e bimeve te uleta.

Masivet gëlqerorë malorë të majave te majeve perreth popullojë disa biotope të jashtëzakonshëm dhe me vlera për ruajtjen natyrore në nivel Evropian. Vrojtimet tregojnë se, këtu takohet një numër prej rreth 78 lloje të dendroflorës. Mund të presupozohet që këto lloje të takohen edhe në afërsi të rajonit në studim si një zgjatje e sistemit në drejtim të masiveve te kodrave perreth.

Brezi i zonës së dushkut nis nga lartësia 600 m deri në 1300 m. në pjesë e konsiderueshme e këtij brezi përdoret nga bujqësia. Pjesa e dendroflorës në këtë system dominohet nga llojet e dushkut (*Quercetum*) me *Quercus petraea*, *Q. frainetto*, *Q. pubescens* ose *Q. cerris*. Drurët e dushkut me *Ostrya carpinifolia* dhe *Carpinus orientalis*, duke treguar një tendencë për përzjerje *Ostryo-Carpinion orientalis* në nivelet më të ulta të lartësive, qe janë gjithashtu pjesë e kësaj zone.

Në vendet e thata dhe shkëmbore dominon *Quercus trojana* (*Quercetum trojanae*). Gjithashtu në mjedise të tilla të ngjashme shfaqet lloji drunor i venjës (*Juniperetum excelsae*). Duke u bazuar në faktin se sistemet drunore shpesh herë paraqiten të vecuara, si dushqet ashtu edhe venjat, në këto biotope hapësirat mbushen me barishte te tilla si *Stipa grasslands* (*Festucetalia*).

Në mënyrë rastësore në sipërfaqe të vogla janë instaluar nga ana e njeriut sisteme të pyjeve me pisha në brezin e dushkut, kryesisht afër qendrave të banuara.

Në pjesën e sipërme të brezit të dushkut takohen komunitete në larmi si *Festuco-Brometea*. Një përzjerje e elementeve Kontinentalë dhe sub Mesdhetarë është tipike në rastet e kalimit nga format kontinentale *Festucetalia* dhe *submediteranea Brometalia*. Zonat e lagura të rajonit ose anët lumore janë të varfëra në veshje dushqesh. Në vende të tilla sistemet e kufizuara ligatinore rrethohen nga kullotat e tilla si tipi *Arrhenatheretum* ose nga sistemet fushore.

Duke u mbështetur në vrojtimet e ndryshme, besohet se 25 lloje bimësh te florës lokale takojnë listës të florës së kërcënuar të Shqipërisë. Nëntë prej tyre janë në nivelin e kërcënimit lokal dhe dy lloje trajtohen si endemike.



- *Pershkrimi i zones se mbrojtur prane vendit ku propozohet projekti.*

Kjo zonë (Zona ku do të ndërtohet Hidrocentrali), nuk gëzon statusin e ndonjë kategorie të mbrojtur (sipas IUCN-s kategorizim i adaptuar nga vendi ynë), si dhe në afërsi të saj nuk ka të tilla me status mbrojtjeje, megjithate ne kuader te rritjes se siperfaqeve te konsideruara si zona te mbrojtura dhe qe jane ne liste per te marre statusin e vecante te mbrojtjes, ky aktivitet mund te integrohet me keto zona me se miri pa e prishur rendesine e tyre.

#### **4.3 Pershkrimi i cilesise se mjedisit dhe ndikimet egzistuese.**

- *Cilesia e ujrave ne zonen e studjuar.*

Persa i perket akuifereve ne kete rrjedhe ujore jane te tipit malor me klime te ashper gjate dimrit dhe te fresket gjate veres. Ne keto ujera verehen lemyshqet dhe algat lumore qe vishen ne faqen e gureve. Perrenjte qe formojne Lumin e Kirit jane nder deget me te rendesishme dhe me uleshmeri te larte per zonen perreth.

Lumi i Kirit ka gjithashtu nje pjerresi te theksuar te shtratit prej 25 % ose nje renie 35 m per cdo 1 km gjatesi te Lumit.

Cilësia e ujërave të ujitjes nga Lumi i Kirit është i mirë dhe ato duhet të përdoren për ujitjen e bimëve që kultivohen në këto zona.

Nuk shkakton probleme të kripëzimit dhe toksicitet në bimët e ndjeshme, por mund të shkaktojë probleme të lehta të infiltrimit në tokë, duke ulur shpejtësinë e tij.

Probleme të lehta mund të paraqiten prej përmbajtjes relativisht të lartë të karbonateve dhe bikarbonateve në dëmtimin e strukturës së tokës.



**Monitorimi i disa treguesve kimikë të ujerave në zone.**

**Rezultatet e analizave kimike të ujerave të lumenjve që përdoren për ujijtje.**

Parametrat	Lumi Kiri			
	M1	M2	M3	M4
Konduktiviteti elektrik	0.6	0.4	0.5	0.47
Kalcium	1.9	1	2.1	5.3
Magnez	4.1	2.4	2.7	3.1
Natrium	0.9	0.7	0.6	0.57
Karbonate	0.7	0.8	0.4	0.6
Bikarbonate	3	2.5	4.1	2.5
Klorure	0.3	0.7	0.9	0.4
Sulfate	0.5	0.9	0.5	0.7
Azoti - Nitrat	0.7	0.5	2	3.44
Azoti – Amonjakal	0.7	0.28	1.88	2.1
Fosfatet	0.06	0.07	0.10	0.04
Potasi	6.42	1.19	5.37	4.89
Aciditeti	7	6.3	7.8	7.9
Koficienti absorbues i Na+	0.58	0.39	0.4	0.37
Mbetje e thatë	0.49	0.3	0.1	0.2



Sasia e joneve të veçantë për Lumin e E Kirit jepet si më poshtë:

Vendmatja	Ca	Mg	Na	K	HCO <sub>3</sub>	Cl	SO <sub>4</sub>	Jone
Lumi i i Kirit	34.2	20.07	4.21	0.93	210.07	9.07	15.03	297.45

#### Ujrat nentokesore

Gjendja e mire ekologjike do te perkufizohet ne baze te parametrave biologjike. Parametrat kimike, fizike dhe hidro-morfologjike konsiderohen vetem si mbeshtetes për zhvillimin dhe ruajtjen e gjendjes se mire biologjike. Megjithate, kalibrimi i vlerave te parametrave biologjike me vlerat limite për gjendje te mire biologjike dhe te tjera klasifikime nuk jane kryer ne Shqiperi dhe ne vendet antare te BE akoma është ne vazhdim. Ne kete situatë është e nevojshme te zbatohet parametrat kimike dhe disa te tjerë fizike për te përcaktuar vlerat limite te kufijve, bazuar ne vlerësimin e eksperteve.

- Cilesia e ajrit ne zonen e studjuar

Sipas **klasifikimit klimaterik** te vendit tone te bere nga Instituti Meteorologjik i Akademise ses Shkencave, zona ne te cilen mendohet te ndertohet HEC, karakterizohet nga nje dimer i ftohte dhe vere e fersket.

- Niveli i zhurmave ne zonen e stutjuar

#### ZHURMAT

Gjate ndertimit Hec Kiri-1, do kete angazhim te makinerive per punime germimi, transporti etj. Per te zbutur efektin e trafikut te ngarkuar dhe te zhurmave qe e shoqerojne ate, me qellim uljen e shqetesimeve per popullaten qe jeton perreth zones se ndertimit te hidrocentralit, si rruge te perkohshme do te perdoren ku te jete e mundur rruget dytesore. Nga projekti jane parashikuar ndertimi i rrugeve ndihmese. Transportimi i materialeve te ndertimit ne rruget egzistuese do te programohet me kujdes per te shmangur cdo shqetesim ne trafikun lokal. Gjate nates, automjeteve do tu kerkohej te operojne me shpejtesi te ulta dhe te ndalohet perdorimi i borive.

Zhurmat do te monitorohen sipas ditës e natës, për 8-orëshin gjatë ndërtimeve. Gjithashtu do të shihen se cilat pjesë përcaktojnë zhurmën, e cila qarkullohet vazhdimisht. Do të





vërehen kriteret dhe normat që duhet të përcaktojnë zhurmat. Menaxheri i vendit të ndërtimit duhet të mbajë dokumentacion për çdo zhurmë gjatë procesit të ndërtimit. Zhurmat do të maten për një periudhë 1 vjeçare, kur parku të jetë në aktivitet të plotë.

- *Administrimi i mbetjeve.*

Administrimi i mbetjeve të ngurta, gjatë ndërtimit dhe pas ndërtimit në hec-it KIRI 1 do realizohet me sistem grumbullues dhe do transportohet në pikat me të afërta në venddepozitimet e mbetjeve të ngurta të cilat janë vendosur në qytetin e Shkodrës

- *Problemet e tjera : si erozioni i tokës , zjarret, etj.*

Në atë zonë ku ka probleme të erozionit do meren masa:

-**Masat agro-teknike** janë masat që janë të përshtatshme për të ndaluar ose zvogëluar erozionin dhe kështu ndalojnë ose zvogëlojnë humbjen e shtresës së pëllëshme të dheut nga toka bujqësore.

-**Drunjtë në brezin mbrojtës** janë një varg drunjesh ose shkurresh të cilat janë mbjell për të ndaluar ose zvogëluar ndikimin e erozionit nga era në rrafshina ose erozionit nga uji në shpate ose në rrafshina që vërshohen.

-**Nën mbjellja** është mbjellja e barit ose llojeve tjera të bimëve, të cilat mbulojnë dheun e zhveshur rreth të mbjellave (kulturave) të cilat nuk e mbulojnë tokën ose lënë hapësira të mëdha të zhveshura të dheut. Qëllimi i nën mbjelljes është të ndalohet humbja e shtresës së pëllëshme të dheut prej ndikimit të erozionit nga era dhe uji.

-**Bashkë mbjellja** është mbjellja e barit ose llojeve tjera të bimëve mes rreshtave të kulturave bujqësore ku të mbjellat nuk e mbulojnë dheun ndërmjet rreshtave. Qëllimi i bashkë mbjelljes është që të ndalohet humbja e shtresës së pëllëshme të dheut nga ndikimi i erozionit të shkaktuar nga era dhe uji.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri do të realizohet sipas normave ligjore të Republikës së Shqipërisë, Evropës dhe normave e rregullave nga praktika teknike.

Mbrojtja nga zjarri është projektuar si instalim statik/fiks dhe do të lidhet në sistemin e hidrantit, i cili furnizohet me ujë nga depoja e ujit për zjarr-fikje. Kapacitetin dhe presionin



në rrjetin e hidrantit e sigurojnë pompat të vendosura në stacionin e pompave. Në sistemin e mbrojtjes nga zjarri janë parashikuar këto masa teknike për mbrojtje nga zjarri:

- Furnizimi me ujë për nevojat e mbrojtjes nga zjarri.
- Rrjeti i jashtëm i hidrantit me hidrantët mbitokësore dhe ormanët për hidrant.
- Pajisjet statike për mbrojtje nga zjarri në çdo objekt.
- Aparatet për zjarr-fikje.
- Sistemi i alarmit të zjarrit (centrali ) dhe lajmëruesit/detektorët në pika të ndryshme të instalimeve.
- Butonat e alarmit në raste emergjente.
- Pajisjet mobile për zjarr-fikje.
- Mjetet për zjarr-fikje u mundësohet hyrjeve.

- Presjonet kryesore te mjedisit ne zonen e projektit , si ndotje te mjedisit, prerje pyjesh etj.

**a. Ndikime në vlerat e pejsazhit etj.**

Ndikime në pejsazhet, vlerat rekreative, sociale dhe ndërkufitare

Vlera mjedisore/ Pejsazhesh	Vlera ekonomike (kullosore)	Aftësi rikrijuese dhe turistike	Vlera social edukative	Vlera ndërkufitare
***	****	***	***	***

\* nuk ka      \*\* të ulta      \*\*\* mesatare      \*\*\*\* të larte

**b. Ndikime në florë dhe vegjetation**

Periudha e punës së Hidrocentralit	Ndikime negative nga gëryerja	Ndikime negative të shkaktuara nga kimikate dhe hidrokarbure	Ndikime positive mbi florën dhe vegjetacionin
Faza fillestare	*	*	*
Maja e lëndëve të	*	*	*



para			
Ndikime pas 5 vjetësh	*	*	*
Ndikime pas masave rehabilituese	*	*	*

\* nuk ka\*\* të ulta \*\*\* mesatare \*\*\*\* të larta

**C .Ndikime në grupet kryesore faunistike**

Periudha e punës së Hydrocentralit	Ndikime mbi gjitarët	Ndikime mbi shpendët	Ndikime mbi faunën peshkore	Ndikime mbi zvaranikët
Faza fillestare	*	*	**	*
Marja e lëndëve të para	* (mbi brejtësit)	*	**	*
Ndikime pas 5 vjetësh	*	*	*	*
Ndikime pas masave rehabilituese	*	*	*	*

\* nuk ka\*\* të ulta \*\*\* mesatare \*\*\*\* të larta

**4.4 Pershkrimi i karakteristikave sociale te zones ku do te zhvillohet project**

- Njesia e qeverisjes vendore qe administroren zonen ku zhvillohet aktiviteti.

Zona ku do zhvillohet projekti I perket komunes Pult te rrethit te Shkodres qe I perket qarkut te Shkodres.



- *Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike te zones.*

**Popullsia me perafersi:**

Të dhëna bazë per Shkodren	
<b>Sipërfaqja:</b>	46.16 km <sup>2</sup>
<b>Banorë:</b>	114 219
Dëndësia e popullsisë:	2474.41 ab./km <sup>2</sup>
Pozita gjeografike:	Ne veri te Shqiperise
Zonat banuese	Ne 2 qytete dhe 9 komuna
Banore local afer H/C	1000 - 2000

Kiri është një fshat në komunën

Pult në rrethin e Shkodrës të Shqipërisë. Fshati është i vendosur në hyrje të Pultit, dukend ekur në të kundërt rrjedhën e lumit me të njëjtinemër. Në lashtësi ka pasur një kala që sot ka vetëm disa rrënoja dhe asgjë më tepër, por edhe sot ky vend emërtohet "Qyteza e Kirit" ose "Kalaja eKaurrit". Popullsia është e përbërë nga disa degëzime.

**Aktivitetet Ekonomike, Aktivitetet Bujqësore dhe Blektorale.**

Aktiviteti kryesor ekonomik për popllsinë vendore është bujqësia. Toka është e shpërndarë duke u mbështetur në Ligjin No.7501, nga ku fermerët përfituan siperfaqe tokë bujqësore per fryme, e mjaftueshme kjo për të plotësuar nevojat e familjeve, por e pamjaftueshme në aspektin e një bujqësie intensive.

Një seri problemesh të tjera si mos mbajtja në gjendje pune e sitemit të ujitjes dhe mungesa e mekanizimit të bujqësisë, kanë ndikur drejtpërdrejtë në një rënie të përgjithshme të bujqësisë në keto zona. Si rezultat i kësaj, toka bujqësore në mjaft raste paraqitet e abandonuar, veçanerisht në pjesën e sipërme të perrenjve qe formojne Lumin e Kirit, duke u përdorur kryesisht si kullote



### **Të ardhurat, Standartet e jetesës dhe Punësimi.**

Burimi kryesor i të ardhurave për popullsinë vendore në komunat e ndryshme, sigurohet nga punësimet në sektorin e bujqësisë dhe të ardhurat nga emigracioni. Popullsia rurale në qark, ndeshet me një seri problemesh, të tilla si mungesa e sistemeve të ujrave të zeza, mungesa e një infrastrukture të përshtatshme, mungesa e ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike. Disa prej këtyre problemeve, u bënë më kritike madje në periudhën e tranzicionit në kuptimin e standarteve të jetesës në zonat e thella ose në kuptimin e thellimit të varfërisë më gjërë.

Transformimi i kooperativave bujqësore dhe mbyllja e mjaft ndërmarrjeve pronë shtetërore në vitet e para të tranzicionit, si pasojë e ristrukturimit dhe privatizimit, solli si pasojë papunësinë.

Pamjaftueshmëria e tokës bujqësore dhe zhvillimi i sektorëve jo bujqësorë u shoqërua me hapjen e disa vendeve të punës, kryesisht në sektorin e ndërtimit. Në këtë situatë, në vecanti të rinjtë janë duke kërkuar një jetesë më të mirë në qytete në sektorët jo bujqësorë. Por, mundësitë janë të kufizuara edhe si pasojë e mungesës së kualifikimit të nevojshëm.

### **Emigracioni dhe të ardhurat.**

Mekanizmi kryesor që buron nga kushtet e vështira të jetës është emigrimi dhe migrimi. Lëvizje të brendëshme migrimi ndeshen në më të shumtën gjatë zhvendosjes nga zonat malore të rajonit të Shkodresit, pasi sipërfaqja e tokës për banorë dhe cilësia e saj është shumë më e ulët në krahasim me atë të zonës së ulët. Përvec kësaj, zonat malore kanë një zhvillim të dobët të infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Migrimet nga zonat rurale kanë krijuar probleme për pushtetin vendor. Këtu, në zonat malore, takohen sipërfaqe të tëra të cilat janë plotësisht të abandonuara.

Sidoqoftë, zona rurale e rajonit të Shkodres, karakterizohet nga një nivel i lartë i emigrimeve, për një periudhë kohe të shkurtër ose të gjatë, në vendet perreth. Shkaku kryesor për emigracionin është punësimi dhe sigurimi i të ardhurave për familjet e tyre. Të ardhurat përdoren kryesisht për plotësimin e nevojë ditore të jetesës në familje dhe sasi të tjera investohen në bujqësi ose sektorë të tjerë.



### **Aktivitetet turistike.**

Në përgjithësi zona e marrë në studim dallohet për një zhvillim të ulët megjithëse ofron atraksione në aspektin e turizmit.

Duke u bazuar në burimet natyrore dhe qendrat e banuara, nxitja e formave alternative të turizmit duket si një perspektivë interesante për zhvillimin ekonomik të rajonit, ndërkohë që lipset respektimi i tërësisë së tij mjedisore, duke përfshirë edhe vlerat kulturore e historike. Pamvarësisht përparimeve, turizmi paraqitet larg të qënurit zhvillim i kënaqshëm. Infrastruktura në aspektet e telekomunikacionit, furnizimit me ujë etj, është mjaft e varfër, ndërkohë që cilësia e shërbimeve ekzistuese turistike, (ngjitje ne mal, rreshqitje ski, gjueti etj), është e ulët.

Sidoqoftë, turizmi është duke marrë një theks të vecantë në kushtet e politikave të reja në vend, të përfshira edhe në Strategjinë për zhvillimin e vendit, si me i organizuari shfaqet turizmi familjar ku njerezit kthehen per pushime ne terren malor.

### **Shërbimet e transportit publik**


Transporti publik nuk është i mireorganizuar, por këtu ekziston një sistem lidhës i fshatrave me qendrat e komunave dhe qytetet me anë të mikrobuzave.

Duke qënë se një pjesë e madhe e fshatrave këtu, shtrihen në distanca te ndryshme të rrugës kryesore te rrethit, lidhjet rrugore janë relativisht te mira, kjo fale edhe investimeve te ndjeshme ne kete sektor nga Fondi i Zhvillimit Rural. Sidoqoftë, infrastruktura rrugore, sidomos në fshatra paraqitet në një gjendje jo të kënaqshme dhe kërkon nderhyrje. Nje gje pozitive per keto fshatra do te ishte investimi ne infrastrukturen rurale - lokale me asfalt qe do te coje ne permiresimin e jetes se banoreve te zones ku akset rurale qe lidhin fshatrat me qytetin e Shkodresit do te ndikoje ndjeshem edhe ne rritjen e numrit te frekuentimit te turizmit malor.

- *Perdorimi i tokes ne zonen e projektit*


Pjesa e sipërme e rajonit përfaqëson habitat dëshqesh qe eshte shfrytezuar intensivisht ne te kaluaren. Lugina e Lumit te Kiridhe rajoni ku do te ndertohej Hidrocentrali KIRI 1, mbulohet nga tre breza tokash ku mund të përmëndim:

Tokat e Kafejta dhe tokat e murrme pyjore që shtrihen në lartësitë më të mëdha.



- Tokat e hinjta kafe që kanë një shtrirje më të vogël dhe të ulët.  
Ndër tokat e kafenjta, vlen të përmendim tokat e kuqërremta, të cilat janë të rënda, të varfëra me lëndë organike dhe minerale. Tokat e kafejta të zakonshme, janë mjaft të grryera për shkak të relievit të thyer, dhe për këtë kanë një trashësi të vogël.
- Tokat e murrme pyjore mbulojnë territor me reliev më të butë, dhe kanë profil të trashë dhe përmbajtje të lartë humusi.







- *Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike ne afersi te zones se projektit*

Gjate hapjes se trasese nuk mundet te takohen objekte dhe trashegimi qe bartin vlera kulturore.

- *Administrimi i mbetjeve dhe ujrave te ndotur urbane.*

Administrimi i mbetjeve te hec-it KIRI 1 do realizohen me sistem grumbullues dhe do transportohen ne pikat me te aferta.

Per ujerat e zeza do te perdoret gropa skeptike.

**5) Pershkrimi i ndikimeve negative te rendesishme te projektit te projektuar mbi mjedisin.**

**5.1 Ndikimet negative ne mjedis.**

- *Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit.*

**Ndikimet ne toke.**

Lloji i ndikimit në tokë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshime topografike të terrenit	✘			✘
Prishja e tokës bujqësore		✘		
Ndotja e tokës nga rrjedhjet	✘			✘
Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta	✘			✘
Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave	✘			✘



- *Ndikimet negative ne habitate dhe biodiversitet te zones se projektit.*

**Ndikimet ne floren, faunen dhe gjeologjine.**

Lloji i ndikimit në florën dhe faunën	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore		↓		↓
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit		↓		↓
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zonës së virgjër		↓		↓
Përçarje apo izolim të habitateve të egra		↓		↓

- *Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi I mbetjeve.*

**DERDHJA E PRODUKTIT NË MJEDIS**

Kjo dukuri është shfaqja më flagrante dhe më e rëndomtë, por e ndjeshme ndaj tij, pasi edhe në sasi të vogël, e transportuar nga uji merr një përhapje të madhe dhe bëhet e pa rikuperueshme.

Derdhjet në mjedis mund të ndodhin vetëm aksidentalisht gjatë transportit me autoçisterna nga përplasjet e tyre eventuale.

Termi derdhje apo rrjedhje është fatal në shëndet e në mjedis, si dhe humbje ekonomike, prandaj është larg për kushte normale të operimit me këto produkte që punohet në siguri të lartë.



Aktiviteti	Parametrat e monitoruar	Kostot	Përgjegjës i
Matja e nivelit të zhurmave	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të bëhet një vëzhgim i strukturës së burimeve të zhurmave.</li> <li>• Realizimi i një harte të nivelit të zhurmave për objektin në fjalë.</li> <li>• Prespektiva e kontigjenteve të popullatës që preken.</li> <li>• Dhënia e sygjërimeve për problemet që mund të hasen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personat të cilët duhet të angazhohen në matje duhet të jenë në profesionet: Njëri fizikant dhe tjetri laborant.</li> <li>• Duhet të parashikohet kostua për automjetin bashkë me karburantin për 7 ditë shërbimi në dispozicion.</li> <li>• Faza e dytë: Zhvillimi i matjeve</li> </ul>	Kompania
Rezultatet e matjeve të hidhen në një raport niveli të zhurmave të matura	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Data, vendi, ora e matjes, përshkrimi i kushteve meteorologjike, shpejtësia dhe drejtimi i erës.</li> <li>• Koha e referimit, e observimit dhe e matjes.</li> <li>• Zingjiri i matjeve totale, duke përcaktuar këtu instrumentin e përdorur, gradën e saktësisë relative, çertifikata e vërtetësisë së tarimit, lloji i destinacionit të objektit për të cilin bëhen matjet, modeli, tipi, dinamika, përgjigjja në frekuenca në rast të përdorimit</li> </ul>		Kompania



*[Handwritten signature]*

	<p>të një sistemi regjistrues ose riprodhues.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista emërore e specialistëve që kanë qenë prezent në matje, si dhe identifikimi dhe firma e specialistëve që kanë bërë matjet.</li> </ul>		
--	---	--	--

- *Ndikimet negative shtese (kumulative) ne cilesine e mjedisit ne zonen e projektit dhe burimet natyrore si mineralet,pyjet,burimet ujore.*

**Ndikimet ne uje**

Lloji i ndikimeve në ujë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Trajtimi i ujërave të ndotur		✘	✘	
Ndotja e ujit prej pluhurit, acideve, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera		✘		✘
Ndikimi sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujërat nëntokësor etj.		✘	✘	
Modifikim në drenazhimin e ujërave natyrorë		✘		✘
Ndotja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor nga llumrat		✘		✘



**Ndikimet ne ajer dhe ne klime**

Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Prodhimi i aerosoleve		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	
		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	

- *Ndryshimet sociale te projektit , si ndryshimi I perdorimit te tokes dhe shqetesimet qe mund te lindin nga ndikimet ne mjedis te projektit si zhurmat,pluhri,perdorimi i burimeve natyrore etj.*

**NDIKIMET NË PËRFTIMIN E TOKËS**

Lloji i ndikimeve në përfitimin e tokës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrim banesash		<input checked="" type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>
Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës		<input checked="" type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>
Rivendosje banesash	<input checked="" type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>	
Shpronësime të tokës	<input checked="" type="checkbox"/>			<input checked="" type="checkbox"/>



*Handwritten signature*

**NDIKIMET NË INFRASTRUKTURE.**

Lloji i ndikimeve në interesin publik (Infrastrukturë)	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshimi i destinacionit të aktivitetit do të ketë ose jo nevojë për ndryshim në këtë fushë të interesit public		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	
Energji elektrike		<input checked="" type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>
Sistemi i komunikacionit		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	
Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	
Sistemi i ujësjellësit		<input checked="" type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>
Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre		<input checked="" type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>

**NDIKIMET NË ENERGJINË**

Lloji i ndikimeve në energji	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Përdorimi i sasive të mëdha të karburantit për energji		<input checked="" type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>
Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime ekzistuese të energjisë apo kërkesave për tipe të reja të energjisë	<input checked="" type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>	



**NDIKIMET NË TRANSPORT & QARKULLIM**

Lloji i ndikimeve në qarkullim dhe transport	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shtime të rëndësishme të qarkullimit të automjeteve		Jo	Jo	
Pakësim të vend qëndrimeve të automjeteve, apo nevoja për vend qëndrime të reja		Jo	Jo	
Ndikime të rëndësishme në sistemin e komunikacionit		Jo		Jo
Ndryshime në qarkullimin apo lëvizjen e njerëzve		Jo		Jo

- *Pershkrimi i pasojave te aksidenteve te mundeshem me pasoja ne mjedis .*

Hydrocentrali do te zhvillohet ne harmoni me vlerat e natyres. Brigjet dhe shpatet e maleve ne zone perbejne habitate potenciale per biodiversitetin e pasur qe mbartin.

Ndertimi i veprave hidroteknike kerkon realizimin e shume punimeve dhe ndertimin e disa veprave (prita, kanali i marrjes se ujit, shtrim tubacionesh, ndertim plintash, ndertim godine te turbinave etj).

Zhurmat gjatë procesit të punës së veprës do të jenë të niveleve të ndjeshme, për personelin e punësuar. Vibracione do të ketë gjithashtu, por punonjësit do të përdorin kufje gjatë kohës së plasjes, ndërsa për banorët do të vijë si oshëtime dhe në nivele normale. Pajisjet lëvizëse janë jo të pakta në numër dhe me fuqi të larta, por më



konstruksione që garantojnë punë në ekuilibër të plotë. Gjatë procesit të punës do të çlirohet nxehtësi.

**PLUHURI**

Në këtë kompleks do të jetë prezent ekzistenca e pluhurit, sepse do të ketë operacione pune që do të shkaktojnë pluhura, sic janë zbankimet, transporti i materialeve te ndertimit. Ambientet e brendëshme dhe të jashtme të veprës do të lahen me ujë pas çdo procesi operacional.

Aktiviteti	Parametrat e monitoruar	Kostot	Përgjegjës i
Matja e nivelit të zhurmave	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të bëhet një vëzhgim i strukturës së burimeve të zhurmave.</li> <li>• Realizimi i një harte të nivelit të zhurmave për objektin në fjalë.</li> <li>• Prespektiva e kontigjenteve të popullatës që preken.</li> <li>• Dhënia e sygjërimeve për problemet që mund të hasen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personat të cilët duhet të angazhohen në matje duhet të jenë në profesionet: Njëri fizikant dhe tjetri laborant.</li> <li>• Duhet të parashikohet kostua për automjetin bashkë me karburantin për 7 ditë shërbimi në dispozicion.</li> <li>• Faza e dytë: Zhvillimi i matjeve</li> </ul>	Kompania
Rezultatet e matjeve të hidhen në një raport niveli të zhurmave të	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Data, vendi, ora e matjes, përshkrimi i kushteve meteorologjike, shpejtësia dhe drejtimi i erës.</li> <li>• Koha e referimit, e observimit dhe e matjes.</li> <li>• Zingjiri i matjeve totale, duke</li> </ul>		Kompania






<p>matura</p>	<p>përcaktuar këtu instrumentin e përdorur, gradën e saktësisë relative, çertifikata e vërtetësisë së tarimit, lloji i destinacionit të objektit për të cilin bëhen matjet, modeli, tipi, dinamika, përgjigjja në frekuenca në rast të përdorimit të një sistemi regjistrues ose riprodhues.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista emërore e specialistëve që kanë qenë prezent në matje, si dhe identifikimi dhe firma e specialistëve që kanë bërë matjet.</li> </ul>		
---------------	--	--	--

• **Linja e transmetimit te energjise**

Numri i shtyllave dhe detaje te tjera te linjes elektrike jane dhene ne studimin elektrik dhe te lidhjes me sistemin energjistik shqiptar te projektzbatimit te HEC-ve te Kirit. Ne skemn llogaritese me poshte jepen dhe gjatesite e linja nga godina HEC KIRI 2 deri ne godinen KIRI 1 e cila rezulton 9.75 km, kurse nga HEC KIRI 1 deri ne Nst/Shkoder rezulton 17km.

SKEMA LLOGARITese E HECEVE TE KIRIT



Numri i sakte dhe tipi i shtyllave, rezultoi pasi u percaktuan trasete e linjave, pasi u ndertua profili gjatesor i linjave 20 dhe 110 KV dhe u vendosen shtyllat me perdoimin e shablloneve. U caktua vendi dhe lloji i shtyllave (shih vizatimet bashkelidhur me relacionin).

Sic shihet nga vendosja ne profilin gjatesor te shtyllave na rezultojne shtyllat si me poshte:



- Per pjesen e linjes 20 KV nga HEC-KIRI-2 deri te HEC-KIRI-1 do jene:

Gjithesej 162 shtylla, nga te cilat,

Shtylla b.a. te centrifuguara ndermjetese: 60 cope dhe

shtylla b.a. te centrifuguara ankerore, kendore, fundore: 102 cope.

- Per pjesen e linjes 110 KV nga HEC-KIRI-1 deri te N/STACIONI SHKODER do jene:

Gjithesej: 104 Shtylla, nga te cilat

Shtylla b.a. te centrifuguara ndermjetese: 63 cope dhe

shtylla b.a. te centrifuguara ankerore, kendore, fundore: 41 cope.

Gjatesia linjes: 17,345 km

Keto te dhena jane te sakta, pasi jane te nxjerra nga vendosja e shtyllave ne profilet gjatesore me metoden e shablloneve.

- **Impakti i linjes elektrike ne mjedis.**

- Bashkeveprimi i njeriut me fushen elektromagnetike, anasjelltas sot konsiderohet si realitet
- Njeriu eshte i ekspozuar ne fushen elektromagnetike

Ka shume studime sot ne bote per efektet e fushes elektromagnetike mbi njeriun si p.sh pasojave patologjike ,riprodhimit,leucemi ose kancerit etj, per shembull nje perfundim i rendesishem i shoqates se mjekeve ne Amerike (**A.M.A**) te formular si vijon :

Ne punimet kushtuar efekteve te fushes elektromagnetike te frekuencave te ulta , deri mesatare nuk eshte vertetuar shkencerisht egzistenca e nje risku shendetesor ne kushtet e ekspozimit qe ne njohim zakonisht. Ky perfundim eshte gati i njevlefshem me ate te shoqates se fizikaneve te Amerikes (**A.F.A**).

Ne nje studim i vitit 2001 me bibliografi te gjere theksohet se fusha elektromagnetike e linjave te tensionit te larte (ne pergjithesi) nuk ka ndikim ne shendetin e njeriut.

Instituti shkencor "**NIES**" ne **SHBA** volumi 508 faqe ,grup studiuesh diskutuar 30 shkencetar raporti perfundimtar ne kongresin Nderkombetar 1999 nuk u perfshine perfundimet : "Per mundesite kancerogjene te rezatimit".

Si perfundim, "**NIES**" thekson: Se ekspozimi ndaj fushave elektromanetike te linjave te tensionit te larte eshte i sigurte dhe mundesite per te patur efekte negative shendetsore jane te dobeta.

Keto perfundime jane arritur duke shqyrtuar linjat mbi **150 kv** pra, **220,380,400** e larte edhe keto kane madhesi te intesitetit "E" te fushave elektrike dhe induksionit "B" te fushave magnetike me te ulta se normat e miratuara.

Largesia e ndertimeve nga linjat eshte :1) **380 kv > 28 m**, 2) **220 kv > 18 m**, 3) **132 kv > 10 m**

( referuar kushteve Italiane).

Te linjave me tension me te vogel nuk kemi largesi te caktuar, por vendoset me afersi 10 m.



**Qellimet kryesore te vnm per kete projekt ne lidhje me linjen elektrike jane:**

- për të identifikuar dhe parashikuar ndikimet e mundshme pozitive dhe negative në mjedis si rezultat i projektit të propozuar;
- për të siguruar masa lehtësuese të cilat deri në zbatimin e projektit do të zvogëlojnë ose kompensojnë ndikimet negative të këtij projekti që rezultojnë në një nivel minimal të degradimit mjedisor;

Qellimi i vizitave ne vendndodhje gjate hartimit te kesaj VNM ishte qe te gjendet nje rruge paraprake per linjen me qellim te behet nje investigim me te detajuar qe se bashku me grupin

inxhinjerik te zgjidhet korridori me ndikim minimal ne mjedis, larg zonave turistike dhe njekohesisht linja te ndertohet me koston minimale te mundshme. Linja sic u theksua edhe me

siper eshte shtrire ne baze te kritereve te meposhtme:

Zonat me numer te madh popullsie duhet te shmangen sa me shume te jete e mundur

Varja e linjes siper shtepive te banuara duhet te perjashtohen

Rezervuaret natyrore duhet te shmangen

Kalimi i luginave duhet te vendoset ne pozicione te pershtatshme

Vemendje e vecante duhet ti kushtohet aspekteve kryesore mjedisore

Te sigurohet aksesimi tek vendndodhjet e shtyllave vecanerisht ne pikat kendore me qellim qe te

lejoje transportimin e percjellseve, trosit dhe izolatoreve si komponentet kryesor te linjes.

Akses ne te ardhmen per qellime te mirembajtjes gjate operimit te parashikuar

Ndikimi ne veprimtarite ndertimore per pronat dhe duhet te konsiderohen koston respektive.

Vemendje e vecante duhet t'i kushtohet gjithashtu rrezikut te erozionit dhe veprimtarive te shembjes ne zonat malore.

**Rekomandimi i Këshillit Evropian mbi ndikimet e fushës elektromagnetike (te linjave elektrike). (FEM).**

Shqetësimet që janë ngritur në lidhje me fushat elektromagnetike kanë të bëjnë me efektet negative të mundshme në shëndet gjatë ekspozimit ndaj fushave të prodhuara artificialisht. Ndërsa efektet akute të ekspozimit ndaj FEM-s janë të vendosura në përgjithësi mirë. Ka një debat të vazhdueshëm për ekzistimin e efekteve afatgjate shëndetësore , kryesisht kancerit. Në shumicën e Shteteve Anëtare, autoritetet vazhdimisht kontrollojnë mundësinë e efekteve të tilla të mundshme negative. Shqetësimi i tillë mund të adresohet përmes rezultateve të hulumtimeve të caktuara. Nuk ka asnjë dëshmi bindëse shkencore se FEM shkaktojnë kancer, dhe rekomandimet për kufizimin e ekspozimit janë bazuar vetëm në preventivë.

Qëllimi kryesor i Rekomandimit të Këshillit për fushën e shëndetit publik është për të siguruar një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes kundër ekspozimit të publikut të shtetërisht ndaj fushave elektromagnetike (FEM), duke siguruar një sistem të mbrojtjes të bazuar në grupin e kufizimeve bazë dhe niveleve të referencës.




**Konkluzion :** Duke iu referuar raportit te mesiperm,rezulton qe nuk ka ndikim te fushave elektromagnetike te linjave elektrike ne mjedis per zonen ku do te ndertohen HEC-et « Kiri 1» dhe « Kiri 1» sepse kemi te bejme me linja te tensionit te ulet) sic eshte paraqitur dhe ne studimin e lidhjes me sistemin per projekt zbatimin e e ketyre HEC-ve.

**Ndikimi I ndertimit te linjes elektriket ne mjedis**

*Theksojme se ndertimi I linjes kalon ne korridore te zhveshura pangacmuar dhe demtuar mjedisin. Do te perdoret copetimi I shkembijve per realizimin e betoneve per bazamentet e kullave. Dote kete grumbullime te perkoheshme gjate ndertimit te materjaleve te ndryshme te ndertimit.*

Siç e kemi permendur edhe me siper linja elektrike do te kete nje gjatesi prej 16.75 km dhe ne perberje te saj do kete 206 shtylla., te cilat do te jene te inkastruara ne themele prej B/a.


Prerja e themelit per secilen shtylle tregohet si me poshte.



**Fig.1 Prerja e themelit te vendosjese se shtylles kendore te linjes elektrike 20kv, nga godina HEC KIRI 1 deri ne godinen HEC KIRI 2.**



**Fig.2 Prerje e themelit te vendosjese se shtylles ndermjetese te linjes elektrike 20kv, nga godina HEC KIRI 1 deri ne godinen HEC KIRI 2.**



**Fig.3 Prerje e themelit te vendosjese se shtylles tip te linjes elektrike 110 kv, nga godina HEC KIRI 1 deri ne godinen N/Stacionin Shkoder- 1, 110/35/6 Kv.**

Per ndertimin e linjes do te shmanget prerja e pemeve dhe bimesise.nese paraqitet nevoja do te sigurohet nje ripyllzim i zonave te prekura.

Ne fazen e vijimit te punimeve do te behet pastrimi i tokes.

Faza e ndertimit te linjes elektrike perfshin proceset vijuese :

Organizimin e punes per hapjen errugeve provizore per levizjen e makinerive dhe hapjen e gropave te bazamenteve te shtyllave elektrike. Realizimi e bazamenteve dhe montimin e shtyllave, shtrirja dhe lidhja e percuesve. Efektet kryesore ne mjedis te ketyre aktiviteteteve pershkruhen si me poshte :

Zona e shtyllave ze nje hapesire rreth 2 fish me shume hapesire krahasuar me hapesiren e nevojshme per bazamentin e shtylles,( 3.5\*3.5 )m2, per secilen shtylle. Si rrjedhoje gjate ndertimit prekja e tokes do te jete rreth 2525 m2. Pas ndertimit te bazamentit dhe shtylles, te tensionit te larte, siperfaqja e prekur nga punimet do te rehabilitohet duke u kethyaer ne gjendjen fillestare. Realizimi i rrugeve te perkohshme per ne zonat e shtyllave do te kufizohet ne disa lidhje te shkurtra ndermjet rrugeve egzistuese per zonat ne fjale. Rruget e perkohshme per ndertimin e bazamenteve kane gjatesi respektive 5ml. Shuma afersisht eshte rreth 1050 ml. N erast teper te veshtire transportimi i materialeve dhe pajisjeve do te behet me helikopter.

Aktiviteti i transportimit te materialit shoqerohet me prodhim zhurme, per shkak te punes se makinerive, e cila eshte e ngjashme me zhurmat e makinerive industriale, ky ndikim ka karakter te perkohshem ne dite dhe muaj, dhe gjate kohes se punes. Teknologjia e ketij aktiviteti nuk intesitet te larte pune, dhe prezence te shume makinerive. Ne pune do te



kete nje kamion nje eskavator, dghe nje vinc, te cilet do te punojne me kohe te kufizuar, ne kohe te ndryshme. Hapja e trasese te rrugeve provizore, dhe bazamentit te shtyllave elektrike mund te shoqerohet me demtim, te bimesise ne varesi te pranise se saj. Sidoqofte ky demtim kufizohet ne disa metra katror per secilen zone. Gjate punimi te bazamenteve (dy dite) aktivitet zhurmas do te jete e pranueshme e krijuar nga eskavatori dhe makinerite e transportiot. Keto zhurma jane te nivelit te lejuar dhe nuk do te perzihen me aktivite te tjera.

Ndikim tjeter i mundesh do te jete prodhimi i pluhurit nga aktiviteti i germimit, te bazamenteve, dhe gazeve te krijuara nga motoret diezel, te mjeteve motorike. Sasia e pluhurit te krijuar dhe gazeve te cilruara do te jete ne sasi dhe kohe.

- **Sa jane nevojat e bujqesise per uje ne terma sasimore apo eshte vleresuar fakti qe ne vere nuk do te funksionojte hidrocentrali?**

Persa i perket bilancit te ujit per ujitje kjo ceshtje eshte menduar nga grupi i projektimit si nje nga ceshtjet kryesore gjate ndertimit te skemes se shfrytezimit hidroenergjitik sepse ne zonen pereth nuk ka sistem ujitje funksionale por vetem nje kanal ujitese i cili ka dale jashte perdorimit i cili ka dale jashte funksionit prej vitesh i cili shtrihet perkatesisht ne derivacionin e HEC „-KIRI 1“. Per kete kanal ujitese eshte menduar perfshirja e tij ne projekt-zbatim jo vetem rahabilitimin e tij ne funksion te perdorimit per shfrytezim hidroenergjitik por edhe shfrytezimin e tij per ujitjen e kulturave bujqesore te zones. Keshtu qe baseni i presionit te HEC KIRI 1 nje i cili do te ndertohet ne fund te kanalit te derivacionit do te pajiset me nje shkarkim fundor nga i cili do te merret prurja per ujitje gjate gjith kohes se veres sepse ky HEC gjate kesaj kohe nuk do te jete ne pune per faktin se dhe prurjet (referuar kurbes se qendrushmerise se prurjeve per vitin mesatar) jane shum te vogla dhe nuk plotesojne as kushtet teknike te turbinave por edhe sespe kjo gje eshte theksuar edhe ne kontraten koncensionare ne te cilen thuhet se: gjate shfrytezimit te HEC KIRI 1 nuk do te preken prurjet per nevoja bujqesore. Me poshte po japim tabelen permbledhes te prodhimit vjetor te HEC KIRI 1 dhe bilancit te perdorimit te ujit per shfrytezimin e HEC-it, per prurje ambintale, per ujitje referuar kurbes se qendrushmerise se prurjeve per vitin mesatar me 50% siguri.

#### REHABILITIMI

- Trajtimi i ujerave urbane dhe jetësore përpara shkarkimit në ujërat pritëse sipërfaqësore e veçanërisht në rezervuare ujore është prioriteti kryesor që do të ndikojë në ruajtjen e pastërtisë së ujrave të përdorura.
- Forcimi i kuadrit ligjor për ruajtjen e ujerave sipërfaqësore (lumenj, liqene), nëpërmjet vendosjes së normave të shkarkimeve urbane dhe industriale në përputhje me ato të vendeve Evropiane.
- Forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional për menaxhimin e planifikuar të zonave lumore mbështetur në një plan kombëtar të zhvillimit të breg lumit.



- Ngritja e një rrjeti monitorimi të rregullt konform standarteve e rekomandimeve ndërkombëtare në të gjithë zonën e breglumis, duke shtuar numrin e stacioneve të kampionimit.
- Vendosja e normave tona kombëtare për ujrat e larjes, në përputhje me rekomandimet e OBSH.
- Përmirësimi i situatës mjedisore të ujërave sipërfaqësore, kërkon realizimin e investimeve në drejtim të përpunimit të shkarkimeve të lëngëta urbane.
- Ka ardhur koha gjithashtu që, industritë që shkarkojnë mbetjet e tyre të lëngëta në ujërat sipërfaqësore të vendit të respektojnë standartet e përcaktuara nga Ministria e Mjedisit. Nga ana tjetër, kontrolli në zbatim të ligjit, do të luante një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.
- Kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes mjedisore të ujërave sipërfaqësore, në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, do të lozte një rol të rëndësishëm në evitimin e ndotjeve në ujërat sipërfaqësore.
- Rekomandojmë: Ndalimin e shfrytëzimit të zhavorëve në shtretërit e lumenjve, për mbrojtjen e shpimeve të shfrytëzimit në tarracat lumore dhe ruajtjen e ekuilibrave hidro-dinamikë e hidrokimikë të ushqimit të akuifereve ujëmbajtëse.
- Që në stadin aktual po propozohen zgjidhje inxhinierike të cilat do të sigurojnë vazhdimësinë e habitateve tokësore dhe ujore duke shmangur fragmentarizimin; nëse do të shikohet propozimi teknik vërehet se nuk do të ketë ndërpreje e plotë për rrjedhjen ujore, gjë që mënjanon fragmentarizimin që do të sillte efekte tepër negative veçanarisht për faunën akuatike.
- Në vijim të rivendosjes së mbulesës bimore në vendet e shfrytëzuara dhe ato që do të shfrytëzohen, në bashkëpunim me strukturat e tjera vendore si Shërbimi Pyjor, Agjensinë Rajonale të Mjedisit etj, te ndërmeren masat e mëposhtme:
  - (a) Përgatitja e terrenit për ripyllëzimin dhe ose pyllëzimin;
  - (b) Ripyllëzimi dhe ose pyllëzimi dhe
  - (c) Rikonstruksioni i cungishteve të degraduara etj.
- Krijimi i basenit ujëmbledhës do të krijojë kushte të një mikroklimë falë efekteve vepruese të mjedisit akuatik duke ndikuar edhe në rehabilitimin e mbulesës pyjore.
- Në terrenet përreth vendeve të shfrytëzimit të argjilës të nxiten praktikat e bujqësisë organike, duke harmonizuar interesat e fermerëve lokalë me mbrojtjen e biodiversitetit.



Një situatë e tillë do të favorizohet edhe falë vendosjes së një ekuilibri të ri në kuadrin e një sistemi pyjor kullosor të cënuar.

- Gjatë fazës së ndërtimit të objektit dhe dhe pas vënies në shfrytëzim është i nevojshëm organizimi i monitorimit të rregullt dhe kompleks të resurseve ujore dhe pyjore që do të synojnë shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre. Ndër grupet biologjike të synuara për tu monitoruar propozohen: (a) gjendja vegjetative e bimësisë dhe lloje treguese të forës; (b) lloje peshqish permanentë të Ciprinideve, Cobitideve e Salmonideve (në tributarët); (c) fitoplanktoni dhe (d) zooplanktoni. Kështu, krahas nevojës së monitorimit të parametrave të cilësisë dhe sasisë së ujit, ndërftija e bioindikatorëve dhe metodave të shpejta të vlerësimit do të ofrojë një mënyrë më të saktë për vlerësimin e gjendjes së ekosistemit ujor dhe tokësor përreth. Kjo është e lidhur ngushtësisht edhe me konceptin e Menaxhimit të Integruar të Ekosistemit dhe principeve të tjera që burojnë nga Water Framework Directive - Direktivës Kuadër për Ujrat e BE-së (Pas proceseve integruese).

#### **Gjatë ndërtimit dhe vënies në punë të veprës sygjerojmë:**

- Vendosja e përgjegjësive dhe vendimarrja sipas hierarkisë.
- Trajnimet specifike
- Monitorimi i cilësisë së ujit dhe të ajrit
- Kriteri për vendosjen e stacioneve monitoruese
- Metodologjitë që duhen përdorur për mënyrën e marrjes së monstrave.
- Trajtime në përdorimin e pajisjeve dhe teknikat korrekte për ruajtjen e monstrës
- Trajtime në laborator si dhe rëndësia në metodat e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë.
- Trajnim për gjetjen e mos përputhjes së situatave dhe procedurat që duhen ndjekur më tej
- Kërkesat e raportimit.
- Trajtime për inspektorët, supervizorët, duke u fokusuar në zonat kryesore mjedisore ku duhet të përqendrohemi.
- Mbajtja, transportimi dhe asgjësimi i materialeve të rrezikëshme.
- Procedurat që përdoren për të eliminuar derdhjen gjatë funksionimit të veprës.
- Kërkesat e sigurisë dhe të shëndetit.
- Mirëmbajtja e aparaturave dhe mjedisit të punës

Monitorimi i zhurmës mjedisore.





**FAZA ZBUTËSE GJATË NDËRTIMIT**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Efektet potenciale</b>	<b>Plani i zvogëlimit</b>	<b>Përgjegjë sitë</b>
Vendi i punës paster dhe i sistemuar	Mungesë i koshash, vend depozitim mbeturinas h	Koshat do të vendosen ne territorin e punës.	Kompania
Vendi i punës pastër dhe i sistemuar	Ndërhyrja në drenazhimi n e tokës dhe të uljes së erozionit	Shkallëzimi final i vendit do të lehtësojë punën dhe do të smangë përmytjet. Për mbrojtjen nga erozioni, do të bëhet një plan drenazhimi. Rrethimi dhe zvogëlimi i këndeve të rreshqitjes do të minimizojë erozionin e tokës gjatë ndërtimit	Kompania
Vendi i punës pastër dhe i sistemuar	Zhurma nga pajisjet	Pajisjet e ndërtimit duhet të jenë sipas Standarteve të Komunitetit Europian 2000/14/EC të Majit 2000. Ky orientim duhet të aplikohet për zbatim, tek prodhuesit e pajisjeve që punojnë me zhurmë. Gjatë kohës së pushimit dhe natës, zhurma duhet të minimizohet. Të gjitha pajisjet duhet të mbahen në kushte të mira pune.	Kompania
Përmirësimi i vendit të punës dhe të rrugëve	Pluhuri	Vaditja e sipërfaqeve të vendit të punës, minimizon pluhurin. Të gjitha pajisjet duhet të mbahen në kushte të mira pune.	Kompania
Kullimi	Ndotja nga	Atje ku gërmimet kërkojnë kullimin, uji i tepërt duhet që të inspektohet për	Kompania



*[Handwritten signature]*

	mbetjet	përmbajtje ndotësish, përpara derdhjes në sistemin e kullimit. Uji i ndotur nga vajrat do të trajtohet përpara derdhjes, ku do të dërgohet në ndarësin e vajit/ujit (OWS).	
Vendndodhja e territorit të marrë	Konfliktet me përdoruesin aktual të tokës	Zona e marrë duhet që të shmangë sipërfaqet bujqësore.	Kompania
Vendndodhja e territorit të marrë	Problemet me komunitetin	Të gjitha lejet dhe aprovimet duhet të merren nga autoritetet e duhura përpara operimit në vend.	Kompania
Vendndodhja e territorit të marrë	Sipërfaqet e zëna me aktivitet	Sipërfaqet e marra duhet të ripunohen për tu përzier me ambientin përreth. Ribimësimi duhet të bëhet në përputhje me bimësinë lokale.	Kompania
Caktimi i vendit për materialet e gërmuara, nëse është e nevojshme	Ndërhyrja në kullimet natyrale	Përcaktimi i materialeve të domosdoshme dhe minimizimi i tepricave (nga planifikimi rigoroz), çon në përdorimin efektiv dhe marrjen vetëm aq sa duhet.	Kompania
Caktimi i vendit për materialet e gërmuara, nëse është e nevojshme	Shqetësimet me tokën	Autoritetet lokale duhet të aprovojnë vendodhjen e përcaktuar. Ata, nuk duhet të ndërhyjnë me tokën lokale në përdorim. Të zhvillohet një bimësi në harmoni me atë lokalen. Të gjitha pjerrësitë dhe vendet e punës të kthehen në kushte të qëndrueshme.	Kompania



Ndërlidhja e sistemit të transmetimit	Shqetësim et me tokën	Sasia e tokës që do të përdoret për ndërlidhjen e transmetimit duhet të minimizohet. Për tokat private duhet të ndiqen procedurat që bazohen në:  Ligjin Shqiptar Nr.8561 datë 22/12/1999; Dekretin e Qeverisë Nr.125 datë 23/03/2000 Dekretin e Qeverisë Nr.147 datë 31/03/2000	Kompania
Sigurimi i ujit të pijshëm	Zvogëlimi i furnizimit me ujë në zonat e banuara	Furnizimi me ujë që do të përdoret në ndërtimin e veprës gjeneruese, duhet të monitorohet për tu siguruar se ai nuk ndikon në ujërat e tjerë në këtë teritor.	Kompania
Burimet e agregatit	Zvogëlimi i burimeve lokale	Nuk do të ketë burime të tjera. Do të përdoren guroret ekzistuese	Kompania
Vepra beton dhe asfalt	Problemet e zhurmës, pluhurit dhe mbetjes potenciale	Uji i derdhur do të drejtohet në vendodhjen e sistemit të kullimit. Zhurma duhet të kontrollohet e të lejohet deri në një nivel të lejueshëm. Nëse është e nevojshme, duhet të instalohen çantat e ajrit. Specifikimet e ECP duhet të përcaktojnë operimet e lejueshme të vlefshme për pronarin/operuesin.	Kompania



*[Handwritten signature]*

Forca ndërtuese	Fluksi i punëtorëve që krijon presion në familjet e shtëpitë përreth.	Fluksi i të punësuarve nuk duhet të kalojë 10-20 persona. Punëtorët duhet të jenë banorë të zonës, dhe të transportohen me autobusë deri në vepër. Duhet të ngrihet një qendër e ndihmës së shpejtë për punëtorët në vepër.	Kompania
Shpërndarja e pajisjeve dhe e materialeve	Rritja e trafikut dhe e pluhurit	Shtrimi i segmenteve rrugore brenda dhe përreth veprës do të ketë efekte positive për trafikun lokalë. Gjatë ndërtimit të rrugës, pluhuri do të minimizohet me vaditje të herë pas herëshme. Duhet të sigurohet edhe rrugë këmbësorësh. Shpejtësia në rrugë duhet të kontrollohet për të evituar aksidentet.	Kompania
Vend i përcaktuar për mbeturinat solide	Problemet potenciale të shëndetit	Mbeturinat solide duhet të largohen nga një kontraktor i licensuar.	Kompania
Vend i përcaktuar për mbeturinat e lëngëshme	Ndotja potenciale e ujit	Për trajtimin e ujërave të zeza, duhet të sigurohet një mjet trajtimi në vendin e veprës.  Nuk do të lejohet shkarkesë direkte e ujërave të mbetur.	Kompania



Ndërtimi i veprës së marrjes dhe i derdhjes	Problemet e burimeve ujore	E rëndësishme është vendodhja e veprës së marrjes dhe e derdhjes. Mbeturinat nga ndërtimi, nuk do të hidhen në çdo hapësirë e vend.	Kompania
Vendodhja finale	Estetika	Tokat do të gjelbërohen në mënyrën më të mirë të mundëshme	Kompania

**MASAT ZBUTËSE GJATË PERIUDHËS SË NDËRTIMIT TË VEPRËS**

Veprimtaria	Ndikimet e mundëshme	Masat zbutëse
<b>Menaxhimi i dherave të ndotura</b>	Shqetësime të mundëshme të shëndetit	Dheu i ndotur do të ruhet në mënyrë të sigurtë nën zonë të asfaltuar për të shmangur përhapjen e ndotësve.
<b>Menaxhimi i mbeturinave industriale dhe inerte</b>	Shqetësime të mundëshme të shëndetit	Fraksionizimi i mbeturinave urbane dhe largimi i tyre
<b>Fuqia punëtore për veprim</b>	Fluksi i punëtorëve krijon trysni mbi banesat dhe trafikun	Fluksi i punëtorëve do të jetë i ulët dhe pjesa dërrmuese e tyre do të jetojë në shtëpitë e tyre. Vetëm specialistet do të akomodohen në ambiente të vecanta.
<b>Furnizimi me ujë të pijshëm</b>	Përkeqësim në furnizimin me ujë të komunitetit	Përdorimi i ujit industrial nga burime të ndryshme



<b>Përfundimi i punimeve</b>	Performanca (Shpërndarja e sedimenteve pezull, cilësia e ujit dhe efektet e tërthorta me jetën ujore).	Nivelim dhe gjelbërim i sipërfaqeve të lira të sheshit, si dhe të ambientit përreth.
------------------------------	--	--

**NDIKIMET NË MJEDIS DHE MASAT ZBUTËSE GJATË SHFRYTËZIMIT**

Parametri Mjedisor	Burimi	Rëndësia e përgjithëshme		
		E ulët (U)	E moderuar (M)	E lartë (L)
<b>Ndotja e ujit</b>	Ujra potencialisht të ndotura nga rrjedhja e "shpëlarjes së parë"	U		
<b>Cilësia e ajrit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çlirimet VOC</li> <li>• Humbjet e avullit nga mbetjet e depozituara</li> <li>• Motorët e pajisjeve</li> </ul>	U U U		
<b>Trafiku</b>	Udhëtimet e kamionëve për ngarkimin dhe prodhimin	U		
<b>Mbeturinat e rrezikëshme</b>	Shkumat e lagura nga impianti ndarës: kimikate/ujë	-		
<b>Mbeturinat e ngurta</b>	Gjatë operimit	U		



## REDUKTIMI I GAZRAVE GHG

- Emisioni baze i gazrave paraqiten si me poshte:

CO<sub>2</sub> 77.4 kg/GJ

CH<sub>4</sub> 0.0030kg/GJ

N<sub>2</sub>O 0.0020 kg/GJ

- Faktori i emisionit GHG eshte ne vleren: 0.937 tco<sub>2</sub>/MWh

Ky eshte nje konkluzion shume i rendesishem pasi mund te perdoret per shitjen e ketyre emetimeve vendeve te caktuara qe kane obligim per plotesimin e targetave te Protokollit te Kiotos.

Blerja duke perdorur mekanizmin CDM te Protokollit te Kiotos do te beje te mundur sigurimin e granteve te caktuara per te perballuar nje pjese te investimit fillestar.

## RRYMAT ENDOGJENE DHE RISKU I TYRE

Nje nga efektet me te diskutueshme te nje centrali gjenerues (siç eshte HEC-i i analizuar) eshte ndikimi i fushave elektrike dhe magnetike ne qeniet njerezore dhe ne mjedisin ne pergjithesi.

Keto fusha cojne ne krijimin dhe induktimin e rrymave elektrike endogjene me ane te se cilave lidhen te gjithë mekanizmat e veprimit biologjik te njohura dhe te panjohura.

Prej shume kohesh jane bere perjekje per te percaktuar marredhenie te qarta ndermjet tyre dhe risqeve si dhe pasojat qe ato japin ne mjedis dhe shendetin e njerezve.

Per te vendosur kufijte e lejuar te ekspozimit eshte bere nje pune e madhe nga shume vende te perparuara, e cila s'eshte gje tjeter vecse ulje e normave qe risku dhe ndikimi ne mjedis te jete sa me i vogel.

Studimi i pare eshte kryer nga nje grup shkencetaresh te sektorit elektrik, mjedisore dhe mjeke sipas te cileve kriteri baze i analizes i marre ne baze te te dhenave shendetesore te pritshme dhe te perashikuara, eshte mekanizmi kryesor i bashkeveprimit me organizmin duke patur parasysh se dukurite biologjike jane atributa te rrymave endogjene.



**Le te japim ne funksion te dendesise se rrymes dukurite biologjike te shfaqura prej tyre.**

- Kur dendesia e rrymes ne organizem eshte ne kufijte  $\delta=(1-10)\text{mA/m}^2$ , nuk kemi te bejme me probleme shendetesore, dendesite e rrymave jane ne pragun e perceptimit te tyre.
- Kur dendesia e rrymes ne organizem eshte ne kufijte  $\delta = (10-100)\text{mA/m}^2$ , vihen ne dukje dukuri te qarta qe kane te bejne me sistemin viziv dhe sistemin nervor qendror.
- Kur dendesia e rrymes ne organizem eshte ne kufijte  $\delta = (100-1000)\text{mA/m}^2$ , vihen ne dukje dukuri te qarta te stimulimit te indeve te eksitueshme dhe jane te mundshme pasoja shendetesore.
- Kur dendesia e rrymes ne organizem eshte me e madhe se kufiri  $\delta = (1000)\text{mA/m}^2$ , mund te vihen re eksasistula dhe fibrilacione ventrikulare.
- Duke marre nje faktor sigurie 10 here, norma te vendeve te ndryshme kane marre si norme, kufizimin e densitetit te rrymes ne kufijte  $\delta = 10 \text{ mA/m}^2$ , per rrymat e induktuara.

**Ne menyre te permbledhur disa nga standartet dhe rekomandimet sipas Instituteve kerkimore-shkencore në botes janë:**

- Duke patur parasysh problemin e rrymave endogjene, pike referimi e ndertimit te normes eshte marre dendesia e rrymes se induktuar prej  $10 \text{ mA/ m}^2$ , pra kjo eshte norma baze referuese.
- Kjo rryme ka ne korrespondence ekspozimin e njeriut ne fushe elektrike me gradient  $25 \text{ kE/m}$ , dhe fushen magnetike me induksion  $5 \text{ mT}$ , te frekuences  $50 \text{ Hz}$ .
- OBSH dhe shume institute te tjera shendesore shteterore e kane konsideruar te pershtatshme, qe ne funksin te kujdesit qe duhet treguar ne varesi te ekspozimit, te kohezgjatjes se tij etj, te rekomandoje kufij me te gjere (per ekspozime me te shkurtra ne kohe) ose me te ngushta (per ekspozime te gjata)

Nga treguesit e mesiperm themi qe fushat elektromagnetike te linjave te tensionit te larte (110, 220, 400 kV si dhe nenstacionet 400, 220, 110 kV) te rrjetit transmetues, jane shume larg dhe jashte limiteve te rekomanduara, per rrjedhim nuk kemi ndikime shendetesore.





**9) Programi i monitorimit te ndikimeve ne mjedis gjate zbatimit te projektit.**

**Programi i monitorimit te mjedisit gjate ndertimit dhe operimit te HEC– it**

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar te gjitha ndotjet e mundshme qe do ti vijne mjedisit nga ndertimi dhe operimi i HEC – it.

Secili nga parametrat e vleresuar gjate fazes se ndertimit dhe qe eshte i percaktuar ne planin e zbutjes do te monitorohet rigorozisht.

<b>Plani i monitorimit gjate ndertimit dhe operimit te Hec – it</b>		
<b>Aktivitetet</b>	<b>Plani i monitorimit</b>	<b>Pergjegjesia</b>
Pastrimi dhe pergatitja e sheshit	Pastrimi i sheshit do te behet ne prani te komunitetit. Do te mbillen 100 drure frutore dhe dekorative.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Pergatitja dhe pastrimi i aksit ku do te kaloje kanali i derivacionit	Ne te dy anet e kanalit do te zevendesohen shkurret me drure te pershtatshme.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Pastrimi dhe pergatitja e vendit ku do te vendoset baseni i presionit	Do te mbillen 10 drure frutore dhe 10 drure dekorative.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Pastrimi dhe pergatitja e aksit ku do te kalojne tubat e presionit	Ne te dy anet e tubave do te mbillen drure.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Pergatitja e sheshit	Realizohet ne prani te komunitetit.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Hedhja e materialeve te nxjerra nga pergatitja e	Do te hidhen ne vendin e caktuar nga komuniteti.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e



sheshit		projektit
Lidhja e centralit me nenstacionin e Fibres nepermjet linjes 20kV	Dokumentimi i tokes qe do te perdoret per kete qellim.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Hedhja e mbeturinave te ngurta	Dokumentimi i sakte dhe hedhjae tyre ne vendet e caktuara.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Fuqia punetore	Autoambulance ne sheshin e ndertimit.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Transpotimi i materialeve dhe agregateve ne shesh	Eliminimi i pluhurit ne atmosfere.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Hedhja e mbeturinave te ngurta	Hedhja e materialeve do te behet ne vendin e paracaktuar.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Hedhja e mbeturinave te lengeta	Hedhja e materialeve do te behet ne vendin e paracaktuar me nje perkujdesje te larte.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Monitorimi i ujit te marre nga Lumi. Pakesimi i ujit te mbetur ne shtrat	Sasia e ujit qe do te merret per HEC – in do te jete ne kufijte e lejuar te prurjeve, duke lejuar nje sasi te tij per mos prishjen e eukilibrave ekologjike. Kjo sasi pasi te kaloje ne kanal do te kthehet perseri ne lume.	Kontraktori i zgjedhur nga kompania zbatuese e projektit
Operimi i pajisjeve dhe	Gjate operimit duhet te	Operatori i HEC-it



makinerive	monitorohet zhurmat te cilat nuk duhet te kalojne deri ne 70decibel.	kompania zbatuese e projektit
Trajtimi i ujrave te zeza	Trajtimi i tyre do te monitorohet sipas standarteve.	Operatori i HEC-it kompania zbatuese e projektit
Trajtimi i materialeve te rrezikshme	Magazinimi i materialeve te rrezikshme ne vendet e paracaktuara duke i monitorua rigorozisht ato.	Operatori i HEC-it kompania zbatuese e projektit
Lidhja e HEC -it me nenstacionin	Monitorimi i fushes magnetike te krijuara.	Operatori i HEC-it kompania zbatuese e projektit


**10)Plani i manaxhimit dhe monitorimit te mjedisit.**

- *Rolet dhe pergjegjsit per zbatimin e seciles mase te propozuar per mbrojtjen e mjedisit ne secilen faze te projektit.*
- *Kostoja perkatesete zbatimit te masave te propozuara per mbrojtjen e mjedisit*
- *Plani i komunikimit dhe informimit te publikut per ndikimet ne mjedis , masat e marra per mbrojtjen e mjedisit dhe monitorimin e ndikimeve ne mjedis gjate zbatimit te projektit.*



*[Handwritten signature]*

### Planet e menaxhimit dhe monitorimit



Monitorimi eshte nje proces i zbulimit te ndryshimeve nese ato ndodhin, si dhe i percaktimit te drejtimit dhe matjes se shtrirjes se tyre. Objektivi themelor i ketij kapitulli eshte qe te ofroje rekomandime te pershtateshme per mbrojtjen e zones, mbrojtjen e shendetit te punonjesve dhe te mbrojtjes se cilesise dhe regjimit te ujrave qe futen ne turbina dhe dalin prej saj, te cilat do te derdhen pastaj ne lume dhe do krijojne problem.

Procesi i monitorimit do te perqendrohet dhe fokusohet:

ne aktivitetin e ketij hidrocentrali, ne faktoret qe gjenerojne ndikime negative ne mjedis, ne efektet e ketyre ndikimeve, dhe ne zbatimin e masave per zbutjen e tyre.

Monitorimet do te kryhen nga vete investitori, dhe ne rast te pamundesise teknike per realizimin e tyre do te kerkohe bashkepunimi i subjekteve te specializuara per fushat perkatese. Verifikimet, monitorimet apo auditimet do te organizohen nga institucionet administrative si ARMO e Elbasanit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.



**-Plani i monitorimit**

Potencialet negative te permendura me siper mund te minimizohen duke marre nje sere masash te cilat cojne ne permiresimin dhe reduktimin e ndikimit ne mjedis.

Preventiv punimesh per rehabilitimin e mjedisit ne vend ndertimin e Hec - it.

Nr	Vendi ku do kryhen punimet	Tipi i bimesise qe do shkulet	Sasia qe do shkulet	Tipi i bimesise qe do zevendesohet	Sasia qe do mbillen	Cmimi per njesi ne Euro	Shuma totale Euro
1	Pergjate kanalit te derivacionit	Shkurre	1200	Shkurre	3600	8	28.800
2	Baseni i presionit	Shkurre	22	Shkurre	66	8	530
3	Tubacioni nen presion	Shkurre	100	Shkurre	300	8	2400
4	Godina e centralit	Shkurre	0	Peme frutore	30	9	270
5	Monitorim i zhurmave				4 here ne vit	500	2000
6	Monitorim i ujit dhe prurjeve te ngurta				4 here ne vit	500	2000
7	Ndihma e shpejte				1	1000	1000
8	Trajtim i Grope septike				1	1000	1000



	ujerave te zeza				
9	Pike grumbullimi mbeturinash te selektuara	Kosha depozitimi mbeturinash	4	250	1000

**Shuma totale 40.000 Euro**

### **1. Masa per parandalimin e rreziqeve dhe aksidenteve**

Normalisht, kjo veprimtari nuk shoqerohet me aksidente industriale qe mund te perbejne rrezik per popullaten e zonen perreth, sepse projekti nuk parashikon perdorim te lendeve te rrezikshme.

Megjithate, nje kerkese rigoroze mbetet kontrolli i gjendjes se vepres se marjes, kanalit te derivacionit, basenit te presionit, tubacioneve te presionit dhe linjes se lidhjes me rretin energjetik, veprimeve ne central, ne rastet e avarive e defekteve.

Vemendje e veçantë i duhet kushtuar mbrojtjes nga zjarri, per faktin se ne central, projekti parashikon edhe dy transformatore fuqie, dhe ne raste te tilla perveç demit ekonomik, ka premisa edhe per rrezik ne afersi te objektit nga prania e vajrave ne keto agregate.

## **L I G J**

**Nr. 10 448, datë 14.7.2011**

**PËR LEJET E MJEDISIT\***

Neni 4

### **Sistemi i lejeve të mjedisit**

1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:

a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/A të këtij ligji;

b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/C të këtij ligji.

2. Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C janë si më poshtë:



- a) Qendra Kombëtare e Licencimeve është autoriteti ku bëhet kërkesa dhe ku lëshohet leja e mjedisit të tipit A, B dhe C;
- b) Ministri është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKL-ja;
- ç) Agjencia rajonale e mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit C dhe që vendos për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKL-ja;
- d) Inspektorati Shtetëror Kompetent është autoriteti që verifikon plotësimin nga operatori të kushteve të kësaj lejeje, pas lëshimit të saj nga QKL-ja.

3. Kushtet e lejes së mjedisit të tipave A, B dhe C rishikohen në çdo kohë nga ministria apo Agjencia Rajonale e Mjedisit, nëse ka ndryshime në legjislacionin përkatës mjedisor, të cilit ato u përmbahen, dhe në raste kur konstatohet nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nëse:

- a) shfaqen elemente të reja ekologjike, të panjohura në kohën e dhënies së saj;
- b) dalin dispozita të reja për mjedisin, që e kërkojnë shprehimisht ndryshimin e saj;
- c) vërtetohet ndotje tej normave të lejuara;
- ç) ka ndryshime themelore të veprimtarisë;
- d) ka përparime në fushën e teknikave më të mira të mundshme, që lejojnë pakësimin e rëndësishëm të shkarkimeve në mjedis dhe që nuk kërkojnë shpenzime të mëdha.

Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull

Si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive

mblidhen bashkë. Nqs nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti **kufi** nënkupton kapacitetin

e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.



	ID	Veprimtaria	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit A	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit C
Industritë energjetike	1.1	Instalimet me djegie	Energjia termike në hyrje është e barabartë ose më e madhe se 50 MW	Inputi (energjia) termike është më e vogël se 50 MW	-----
	1.2	Rafineritë e vajrave dhe gazeve minerare	Të gjitha instalimet	-----	-----
	1.3	Furrat e koksit	Të gjitha instalimet	-----	-----
	1.4	Instalimet e gazifikimit dhe lëngëzimit të qymyrit	Të gjitha instalimet	-----	-----
	1.5	Kërkimi i naftës dhe e gazit natyror	Të gjitha instalimet	-----	-----
	1.6	Nxjerja e naftës dhe e gazit natyror	Të gjitha instalimet	-----	-----
	1.7	Gaz natyror aromatik ose GNL pervec rasteve kur veprimtaria është e lidhur me Tipin A, ose përzjerje e aromave	-----	Të gjitha instalimet	-----

**Bazuar ne ligjin 10 448 “Per lejet e mjedisit” veprimtaria dhe kapacitetit prodhues HEC-ve te Kirit futet ne Lejen mjedisore te tipit “B”.**

• **Te dhenat per bimesine**

Sic shihet dhe nga planvendosja e HEC- ve shohim qe veprat perberese shtrihen mbi zona pyjore te cilat jane ne administrim te shtetit dhe jo ne toka bujqesore ose prona private

Te gjitha te dhenat per bimesine pervec atyre qe jane mbledhur gjate investigimit te grupit te projektimit ne terren, jane marre te dhena dhe nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor, Lezhe te siguruar keto nga investitori.


**PER TE EVITUAR NGJARJET E PADËSHIRUESHME & AKSIDENTET NE PUNE DUHEN MARRE KETO MASA:**

1. Rreziqet e aksidenteve, si p.sh. ato qe nuk mbulohen ne Direktiven e VNM, ose te Rregullimeve implementuese.
2. Perpilim e miratim i rregullores se brendeshme per personelin drejtues e zbatues, duke percaktuar detyrat e pergjegjesite e sejcilit ne lidhje me sigurine ne pune e mjedis, ne perputhje me kodin e punes e ligjet e tjera ne fuqi.
3. Punesimi i nje personeli te kualifikuar gjate fazes se ndertimit & ne veçanti gjatë shfrytëzimit.





4. Paisje me rregullore te sigurise ne pune, vendosja e tyre ne vende te dukshme, sipas natyres e shkalles se rrezikut gjate fazes se ndertimit e shfrytezimit te objektit.
5. Zberthim i kartes teknologjike te makineri-paisjeve, radha e venies ne pune te tyre, e afishim ne afersi te tyre ne korniza te rregullta.
6. Kompletim i punonjesve me mjetet e mbrojtjes ne pune, sipas kerkesave ligjore, e ushtrim kontrolli per perdorimin e tyre.
7. Ne veçanti, kujdes duhet te tregohet ne mbrojtjen e punonjesve nga ekspozimi i zhurmave, duke i paisur me mjete mbrojtese sipas kerkesave ligjore per mjedise te tilla pune.
8. Rritje e nivelit te gadishmerise teknike, me sherbime periodike sipas nje programi te miratuar ne konsulence edhe me ekspertet sipas fushave, bazuar ne kerkesat teknike per mirembajtje te objekteve te kesaj natyre.
9. Te sigurohet rrjeti i komunikimit me strukturat e sistemit energjetik.
10. Instruktim paraprak e periodik i punonjesve çdo tremujor sipas profesioneve nga specialiste te fushes, & evidentim i kesaj procedure ne regjistrin perkates, sipas kerkesave ligjore. Per specialistet elektrike, behet marrje ne provim e paisje me deshmi nga Inspektorati Elektrik ne Tirane.
11. Krijimi i paketes se ndihmes se shpejte.
12. Kontroll periodik e shendetesor i punonjesve, e sigurim i mjekut te shoqerise sipas kerkesave ligjore. (Sipas kriterave te përcaktuara nga Ministrisa e Shendetesise), & evidentim i kesaj procedure ne nje regjister te veçante).
13. Te merren masat ligjore per mbrojtjen nga zjarri, duke instaluar paisjet e nevojshme, strukturuar personelin, afishuar ne vende te dukshme radhen e veprimeve ne situata te tilla, nen monitorimin e strukturave pergjegjese.
14. Te mbahet lidhje e vazhdueshme me organet lokale, e te njoftohen menjehere strukturat pergjegjese ne rast aksidenti.
15. Detyrimet e punedhenesit e punemarrsit per punonjesit, si gjate ndertimit dhe shfrytezimit te linjes, duhet te percaktohen me kontrate pune individuale, ne perputhje me kodin e punes dhe aktet e tjera ligjore.
16. Ka marreveshje me vete, ne fuqi, qe lidhen me mbajtjen ose perdorimin e substancave te rrezikshme, dhe Ekzekutivi per Shendetin dhe Sigurine, i siguron autoriteve lokale te planifikimit keshillime rreth vleresimit te rrezikut mbi aplikimin e planifikimit qe perfshin nje instalim te rrezikshem. Megjithate, eshte mire qe ate ku eshte e mundur, rreziku i aksidentit dhe i ndikimeve kryesore mjedisore, te



konsiderohen se bashku, dhe qe projektuesit dhe autoritetet planifikuese, duhet ta kene gjithmone parasysh kete gje.

**Pergatitur nga :**

“TAULANT”sh.p.k.

QKL, LN-7574-03-2014

Eksperte mjedisi:

Ditika Qatipi

Erjona Qatipi

**Bashkepunim me, “EBS” sh.p.k.**

Ing.hidroteknik Fahri MAHO

Ing. hidroteknik Julian Çela



**Investitor**

“ACCESS ENERGY ALBANIA”sh.p.k



Tiranë, 2014.